REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**
**KRYETARI**

*Adresa: Rruga Rruga "Abdi Toptani" Nr. 1 Tiranë. E-mail: klsh.org.al; ŵeb-site ŵŵŵ.klsh.org.al*

Nr. 6/8 Prot. Tiranë, më, 12. 05. 2018

# V E N D I M

## Nr. 42, Datë 12/05/2018

## PËR AUDITIMIN E RREGULLSHMËRISË FINANCIARE NË AKTIVITETIN EKONOMIK, TË USHTRUAR NË BASHKINË BELSH

Bazuar në standardet INTOSAI dhe në Manualet e Auditimit të KLSH-së, llojin e opinioneve të audituesit, si dhe bazuar në punën e kryer në subjekt mbi bazën e evidencave, rezultatet e auditimit, të cilat në mënyrë të përmbledhur janë paraqitur në seksionin III, "Gjetje rekomandime", opinioni ynë si auditues është:

**<u>Baza për opinion të kualifikuar</u>**

Nga auditimi u konstatua se nga mos zbatimi i kuadrit rregullator në fuqi në fushën e zhvillimit të procedurave të prokurimit publik, e cila ka të bëjë me shkelje në kualifikimin dhe shpalljen fitues të operatorve ekonomik, në tre prej tyre është shkaktuar dëm ekonomik në vlerën 11,404 mijë lekë. Në fushën e zbatimit të kontratave të punimeve, në 7 prej tyre, u konstatuan shkelje për volume pune të likuiduara por të pakryera në fakt e për llogaritje të gabuar të fondit limit, të cilat kanë shkaktuar dëm ekonomik buxhetit të njësisë vendore në vlerën totale 67,389 mijë lekë.

Për arsye të kualifikimit dhe shpalljes fitues të operatorve ekonomikë në kundërshtim me kërkesat ligjore, pasi nuk plotësojnë kriteret e DST, janë përdorur fonde publike pa ekonomicitet, eficence dhe efektivitet në vlerën 286 milion lekë, e cila përbën 1/3 e numrit të tenderave të zhvilluar, ose 52% e vlerës së kontratave të lidhura.

Nuk janë ndjekur procedurat e duhura ligjore për arkëtimin e taksave dhe tarifave vendore, e si rezultat janë krijuar debitor në vlerën totale 59,9 milion lekë, e ardhur e munguar për buxhetin e njësisë vendore, si dhe nuk ka evidentim të sakt për subjektet që zhvillojnë aktivitet pa u rregjistruar në QKR.

Në kundërshtim me bazën ligjore përkatëse, janë falur nga këshilli bashkiak detyrime të taksave dhe tarifave vendore në vlerën 333 mijë lekë për biznesin dhe në vlerën 4.9 milion lekë për familjarët.

Nuk është krijuar regjistri i aseteve dhe nuk është bërë marrja në dorëzim me procesverbale e tyre, nga institucionet e tjera në pronësi të të cilave kanë qenë këto asete, rrjedhimisht nuk është kryer identifikimi, inventarizimi fizik dhe regjistrimi në kontabilitet, nuk është aplikuar në ZVRPP Elbasan për regjistrimin e të gjitha aseteve. Nga mos menaxhimi i mirë i tyre janë shkaktuar të ardhura të munguara për buxhetin e njësisë vendore në vlerën 413.9 milion lekë.

Në fushën e urbanistikës dhe IMTV nuk janë marrë masa për arkëtimi e gjobave të aplikuara e cila përbën të ardhur të munguar në vlerën 2.5 milion lekë.

**<u>Opinion i kualifikuar</u>**

Nga auditimi i rregullshmërisë, mbështetur në standardet INTOSAI dhe në Manualet e Auditimit të KLSH-së, nga auditimi i kryer në subjektin “Bashkia Belsh”, rezultuan devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi (kriteret), të cilat në gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë materiale, por jo të përhapura, efektet e të cilave justifikojnë dhënien e një opinioni të kualifikuar. Evidencat e auditimit të ofruara janë të mjaftueshme dhe ofrojnë bazën e arsyeshme për dhënien e opinionit të kualifikuar.

Pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe Projektvendimin e paraqitur nga Grupi i Auditimit të Departamentit të Auditimit të Vetëqeverisjes Vendore, shpjegimet dhe komentet e dhëna nga subjekti i audituar, si dhe vlerësimet mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Kryeaudituesi, Drejtori i Departamentit të mësipërm, Drejtori i Departamentit Juridik dhe Kontrollit të Zbatimit të Standardeve të Auditimit dhe Etikës, si dhe Drejtori i Përgjithshëm, në mbështetje të neneve 10, 15, 25 dhe 30, të ligjit nr.154/2014, miratuar në datën 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”,

# V E N D O S A:

**I.** Të miratoj Raportin Përfundimtar të “Auditimit të përputhshmërisë, të ushtruar në institucionin “Bashkia Belsh, sipas programit të auditimit nr. 6/1 prot., datë 18.01.2018, njoftimit për ndryshim në programin e auditimit me shkresën nr.6/2 prot., datë 26.02.2018, si dhe njoftimit për ndryshim në programin e auditimit, me shkresën nr.6/3 prot., datë 19.03.2018, për veprimtarinë nga data 01.01.2016 deri më datë 31.12.2017.
**II.** Të miratoj rekomandimet për përmirësimin e gjendjes dhe të kërkoj marrjen e masave sa vijon:

## <u>A.MASA ORGANIZATIVE:</u>

Bazuar në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 15 germa (b) dhe (c) –Të drejtat e KLSH dhe mbështetur në nenet 98-102, të ligjit nr. 44/2015, datë 30.04.2015 “Kodi i procedurave administrative në Republikën e Shqipërisë”, nenet 21-33, të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe pikën 93, të udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 ”Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, **nga Titullari i njësisë publike**, të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore (Padi Gjyqësore) duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e vlerës së të ardhurave të munguara. **Nëpunësi zbatues** të ndjekë procesin me qëllim arkëtimin e vlerës **65,929 mijë lekë**, e ardhur e munguar, si më poshtë:
**1. Gjetje nga auditimi:** Bashkia Belsh nuk ka ngritur një sistem efektiv të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, duke mos hartuar një kuadër të plotë rregullash të shkruara për funksionimin e institucionit. Nuk janë hartuar rregulla për ruajtjen e aktiveve. Nuk është hartuar rregullore e kodit të etikës, arkivës, regjistri i riskut, gjurma e auditimit, si dhe nuk është ngritur grupi për menaxhimin strategjik. Mungon kryerja e analizës së funksionimit të sistemit të kontrollit të brendshëm nga titullari, duke mos përcaktuar mangësitë dhe masat që duhen marrë, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, neni 8, 16, 22, 23, 24 *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqe 23-24 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
**<u>1.1 Rekomandim</u>**: Nga Kryetari i Bashkisë Belsh të hartohet një kuadër i plotë rregullash të shkruara, për secilin sektor dhe drejtori, të cilat ndihmojnë stafin në kryerjen sa më mirë të

detyrës funksionale. Të hartohet rregullorja e kodit të etikës, arkivës, regjistri i rriskut, si dhe për proceset kryesore të punës që zhvillohen në institucion të hartohet gjurma e auditimit dhe lista e proceseve të punës. Të monitorohet nga titullari sistemi i kontrollit të brendshëm, duke bërë përmirësimet e nevojshme në vazhdimësi.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

**2. Gjetja nga auditimi**: Nga IVMT janë nxjerrë pesë vendime administrative me gjobë në vlerë e mbetur **2,500,000 lekë**, e cila nuk është arkëtuar, duke shkaktuar të **ardhura të munguara** për buxhetin e njësisë vendore. Nuk janë marr masa në rrugë administrative e gjyqësore për arkëtimin e tyre, veprime në kundërshtim me neni 16, të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve" i ndryshuar, ligjin nr. 10279, datë 20.05.2010 "Për kundërvajtjet administrative". Për vendimet e gjobave të pa arkëtuara nuk janë llogaritur vlera e kamatëvonesave. Nga IMTV dhe Drejtoria Juridike, nuk është kërkuar në Gjykatën Administrative kthimi i vendimeve të gjobave në tituj ekzekutiv *(Më hollësisht trajtuar në pikën 6, faqe 195-198 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**<u>2.1. Rekomandim</u>**: Kryetari i Bashkisë Belsh të nxjerrë përgjegjësitë për mos arkëtimin e 5 gjobave të vendosura në vlerën **2,500,000 lekë**, mos kthimin e tyre në titull ekzekutiv dhe mos llogaritjen e kamatë-vonesave. Në vazhdim të marrë të gjitha masat nëpërmjet strukturave përkatëse, Sektorit të IMTV, Sektorit Juridik, Drejtorisë Ekonomike, për arkëtimin e vlerës së gjobës dhe kamatëvonesës, duke kërkuar kthimin e vendimeve të gjobave në tituj ekzekutiv. Arkëtimi të kërkohet prej kundërvajtjësve për të cilët është aplikuar gjoba: **I.D.**, **F. Xh.**, **V.T.**, **P.Z.**, **F.S.**, në vlerë të barabartë prej **500,000 lekë për secilin**. Në rast të pamundësisë së kërkimit të pagesës nga qytetarët për shkak të kalimit të afateve (parashkrimit), kjo vlerë të kërkohet prej personave të cilët nuk kanë marrë masa në kohë për arkëtim.

**Menjëherë**

**3. Gjetje nga auditimi:** Në objektin *"Ndërtimi i pedonaleve dhe korsive të biçikletave, Performanca dhe realizimi i veprave të artit, Liqeni Belsh"*, nga auditimi rezulton se në Zonën A nuk është vendosur bordura 20x35 cm, sipas projekt-preventivit, por bordurë 20x30 cm. Gjithashtu, vendosja e 78 copë shtylla metalike për ndriçim me H=3m, d=160 mm, nuk është bërë sipas specifikimeve teknike, pasi diametri i shtyllave të vendosura në vepër është mesatarisht 80 mm. Gjithashtu në këtë objekt nuk ka asnjë të dhënë rreth zbatimit të tij. Ndërmjet sipërmarrësit dhe AK nuk ka asnjë komunikim shkresor rreth ecurisë së zbatimit të kontratës. Punimet për këtë objekt nuk janë kryer dhe nga ana e AK nuk është marrë asnjë masë për ndjekjen e zbatimit të kësaj kontrate *(Më hollësisht trajtuar në pikën 4.b, faqe 140-145 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**<u>3.1. Rekomandim</u>:** Nga Bashkia Belsh të merren masa për zëvendësimin e bordurave të vendosura, me bordura 20x35 cm dhe të shtyllave të ndriçimit, me shtylla metalike për ndriçim me H=3m, d=160mm, sipas specifikimeve teknike të projektit dhe dokumenteve standarde të tenderit. Në rast pamundësie, Bashkia Belsh të negociojë me Sipërmarrësin e Punimeve për një çmim të ri, më të ulët se çmimi i situacionuar dhe pas rillogaritjes së diferencës të kërkojë në rrugë ligjorë arkëtimin e shumës së dakordësuar. Nga Bashkia Belsh të merren masa për ndjekjen dhe monitorimin e zbatimit të këtij objekti sipas kontratës dhe nxjerrjen e përgjegjësive për gjendjen e deritanishme.

**Menjëherë**

**4. Gjetje nga auditimi:** Në riparimin e automjeteve konstatohen praktika të blerjes së pjesëve të këmbimit nga vetë institucioni dhe vendosja e tyre nga punonjës të tij, shërbime jo profesionale të cilat nuk garantojnë cilësi. Gjithashtu në një rast është bërë shërbim automjeti emergjent për riparime të rëndësishme të cilat kapërcejnë gjendjen e emergjencës si nga vlera edhe nga numri i shërbimeve të kryera *(Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 47-50 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**<u>4.1. Rekomandim</u>**: Bashkia Belsh për riparimin e automjeteve të ndjekë praktika të cilat bëjnë të mundur që më parë të bëhet përcaktimi i defekteve e nevojave konkrete të mjetit në servis të licencuar dhe mbi bazën e certifikatës së lëshuar prej tij të kryhen riparimet e nevojshme, duke eleminuar blerjen e pjesëve të këmbimit dhe vendosjen e tyre nga vetë punonjësit. Në mënyrë që të eleminohen përsëritjet në kryerjen e shërbimeve të njëjta dhe nga operatori ekonomik të rritet përgjegjësia, prej tij të kërkohet garanci për shërbimin e kryer.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

**5. Gjetje nga auditimi** Me fondet e Bashkisë Belsh në vitin 2017 është kryer prokurim në vlerën **3,816,000 lekë** për blerjen e 2,000 matsave të ujit,me çmim 1908 lekë/copa, për llogari të shoqërisë "**U." SHA**, e cila ka fondet dhe buxhetin e vet. Nga Bashkia nuk janë marrë masa për kthimin e vlerës së mësipërme në buxhetin e njësisë vendore, pasi bazuar në kontratën e ujit të pijshëm midis abonentit dhe **"U." SHA**, vlera e matsave paguhet nga qytetarët. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 47-50 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**<u>5.1. Rekomandim</u>**: Bashkia Belsh në bashkëpunim me shoqërinë **"U." SHA** të marrë masa për kthimin në llogarinë e vetë, të vlerës **3,816,000 lekë** shpenzuar për blerjen e 2,000 matsave të ujit të pishëm për llogari të **"U." SHA**, në të kundërtën të paguhen nga urdhëruesit e blerjes së matësve të ujit të pijshëm.

**Menjëherë**

**6. Gjetje nga auditimi**: Nga auditimi u konstatua se ka diferenca të dukshme midis treguesve të hartimit dhe zbatimit të buxhetit. Në total treguesit e buxhetit janë realizuar në masën 79,5 %, nga i cili zëri "Investime", është realizuar me vlerën më të ulët, ose në masën 53.7%. Për vitin 2017, treguesit e buxhetit janë realizuar në masën 78.5%, nga i cili zëri investime është realizuar në 59%. Planifikimi i zërave të shpenzimeve dhe investimeve dhe mos realizimi i tyre për shkak të mos realizimit të të ardhurave sjellin mos plotësimin e nevojave reale të komunitetit dhe ulje të performancës të njësisë vendore në drejtim të këtyre shërbimeve. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 24-30 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**<u>6.1.Rekomandim</u>:** Në mënyrë që të mos krijohen diferenca të dukshme midis parashikimit dhe realizimit të buxhetit, Bashkia Belsh të marrë masa për hartimin e një buxheti real, mbështetur në realizimin e mundshëm e objektiv të të ardhurave.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

**7. Gjetje nga auditimi:** Si rezultat i moszbatimit nga institucioni të procedurave ligjore për largimin e punonjësve nga puna në Bashkinë Belsh u konstatua efekt negativ financiar në buxhet në vlerën **1,496 mijë lekë**, efekte të cilat janë të mundura të eliminohen nga institucioni, duke ndjekur procedurat e duhura ligjore për largimit e punonjësit nga puna. Përpara zbatimit të vendimit gjyqësor, nga titullari nuk janë nxjerrë përgjegjësitë administrative dhe nuk është nxjerrë akti që provon gjurmën e auditimit të këtij procesi, në kundërshtim me kërkesat e pikës 62 të udhëzimin nr.2, datë 06.02. 2012 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit" *(Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 33-36 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**<u>7.1. Rekomandim</u>**: Në rastet e ndërprerjes së marrëdhënieve të punës me punonjësit, nga institucioni të zbatohen të gjitha procedurat ligjore të largimit, me qëllim shmangien e efekteve negative në buxhet. Nga titullari, përpara zbatimit të vendimeve gjyqësore, të analizohen këto vendime, të nxirren përgjegjësitë administrative, duke përcaktuar shkakun e ndodhjes së tyre, si dhe të nxiret akti që provon gjurmën e auditimit të këtij procesi.

**Menjëherë**

**8. Gjetje nga auditimi:** Këshilli i Bashkisë Belsh me vendimin nr. 42, datë 22.07.2016 dhe vendimin nr. 61, datë 29.09.2017, respektivisht ka zbritur me 30% nivelin e taksës së tokës bujqësore për të gjitha vitet e prapambetura nga familjarët dhe me 30% nivelin e taksës së biznesit të vogël për të gjitha bizneset debitore deri në vitin 2015, me pasojë të ardhura të

munguara për buxhetin e njësisë vendore në vlerën totale **5,271,713 lekë**, nga e cila 333,113 lekë në ngarkim të subjekteve private dhe 4,938,600 lekë për familjarët. Këto vendime tejkalojnë kompetencat ligjore të pushtetit vendor dhe janë të pa bazuara ligjërisht. Të drejtën për faljen e ka vetëm Kuvendi i Shqipërisë, bazuar në Kushtetutën e RSH, pjesa e trembëdhjetë -Financat Publike, neni 155 ku përcaktohet: *Taksat, tatimet dhe detyrimet financiare kombëtare, lehtësimi ose përjashtimi prej tyre i kategorive të caktuara të pagesave, si dhe mënyra e mbledhjes së tyre të caktuar me ligj.* Për këtë arsye, të gjitha diferencat që rrjedhin nga kjo ulje e detyrimeve nga këshilli bashkiak, konkretisht në vlerën 333,113 lekë për biznesin dhe në vlerën 4,938,600 lekë për familjarët nga taksa e tokës, të hequra nga kontabiliteti, përbëjnë të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Belsh *(Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe 150-162 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**8.1. Rekomandim:** Bashkia Belsh, të regjistrojë detyrimin dhe të marrë të gjitha masat e nevojshme ligjore për arkëtimin e vlerës **5,271,713 lekë**, nga e cila **333,113 lekë** në ngarkim të subjekteve private dhe vlera **4,938,600 lekë** për familjarët të cilët kanë përfituar nga falja e paligjshme e bërë nga këshilli bashkiak (sipas listave të trajtuara në anekset e Raportit Përfundimtar)

**Menjëherë**

**9. Gjetje nga auditimi:** Nga sektori i taksave dhe tarifave vendore të Bashkisë Belsh, nuk janë marrë masat e duhura për kontrollin e subjekteve juridikë dhe fizikë që ushtrojnë aktivitet në territorin e Bashkisë Belsh. Nga grupi i auditimit u bë sondazh në faqen zyrtare të QKB-së për sektorin e peshkimit dhe u konstatua se ka një sasi të konsiderueshme biznesesh që nuk figurojnë në regjistrat e tatimpaguesve të Bashkisë Belsh, me pasojë të ardhura të munguara për detyrimet e taksave e tarifat vendore në vlerën **1,865,070 lekë**, veprime në papajtueshmëri me nenin 40 e 41, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar *(Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe 150-162 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**9.1.Rekomandim:** Bashkia Belsh të marrë masa për regjistrimin e subjekteve të pa regjistruar e të konstatuar nga KLSH-ja sipas listës së lënë në këtë projekt raport me vlerat përkatëse, të regjistrojë detyrimin **1,865,070 lekë** dhe të kërkojë sipas ligjit arkëtimin e tij. Të zhvillojë në vazhdimësi korrespondencë me QKB-në dhe Drejtorinë Rajonale Tatimore të rrethit Elbasan për evidentimin dhe regjistrimin e të gjithë subjekteve që zhvillojnë aktivitet në njësinë vendore.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

**10. Gjetje nga auditimi:** Si rezultat i mos marrjes së masave të duhura për vjeljen e taksave dhe tarifave vendore, deri në datën 31.12.2017 janë krijuar debitorë në vlerën totale **59,912,431** lekë **e ardhur e munguar,** nga e cila vlera **5,878,132 lekë** nga debitorët biznese privat dhe vlera **54,034,299 lekë** nga debitorët e kategorisë familjare për taksën e tokës bujqësore *(Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe 150-162 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**10.1-Rekomandim**: Zyra e taksave dhe tarifave vendore,në bashkëpunim me drejtorinë ekonomike dhe atë juridike, të marrë masa për arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifat vendore në vlerën **59,912,431** lekë. Për bizneset, bazuar në nenin 70 pika 3 "E drejta për të nxjerrë njoftimin e vlerësimit tatimor", të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për Procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, **të nxirren njoftim vlerësimet tatimore për debitorët dhe të ndiqen rrugët e mëposhtme:**

**a-**Tu dërgohen bankave të nivelit të dytë urdhrat e bllokimit të llogarive bankare, bazuar në nenin 90 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore RSH".

**b-**Të dërgohet në Drejtorinë Rajonale të Transportit, kërkesa për vendosjen e barrës siguruese (për mjetet) dhe në ZVRPP (për pasuritë e paluajtshme), bazuar në nenin 91 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore në RSH".

**c-** Për subjektet të cilët nuk paguajnë detyrimet tatimore në afat, bazuar në nenit 114, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008, "Për Procedurat tatimore në RSH " të ndryshuar, me ligjin nr. 164/2014 datë 15.12.2014, ndaj tyre të llogariten në vazhdimësi kamat vonesa.
**d-**Në rast se bizneset private edhe pas njoftimeve zyrtare dhe dërgimit të urdhër bllokimeve në bankë nuk kryejnë pagesën e detyrimeve, pasi te merren masat administrative apo sekuestro, të bëhet kallëzim penal, bazuar në Kodin Penal të R.SH, miratuar me ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995 me ndryshimet e mëvonshme, neni 181,-*Mospagimi i taksave dhe tatimeve***.**
**e.** Zyra e taksave dhe tarifave vendore të evidentojë dhe listojë në mënyrë elektronike **abonentët familjarë** dhe të merren masa për arkëtimin e taksës së tokës **nga fermerë,** sipas të dhënave që disponon Gjendja Civile, **të njoftohen** tatimpaguesit familjarë **edhe në median lokale** të Bashkisë për të paguar detyrimin tatimor. Në zbatim të pikës 71, të udhëzimit plotësues të Ministrisë Financave nr. 01, datë 15.01.2016 "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2017", njoftim vlerësimet t'ju dërgohen nëpërmjet Zyrës Postare familjarëve të cilët nuk kanë paguar detyrimet për taksën/tarifën e pastrimit, ndriçimit, banesave, gjelbërimit etj.

**Menjëherë**

**11. Gjetje nga auditimi:** Nga verifikimi i subjektet që tregtojnë hidrokarbure dhe nënprodukte të tyre, u konstatua se 8 subjekte me aktivitet tregtinë e karburanteve nuk figurojnë të regjistruar në të dhënat e bashkisë për liçencat e tregtimit të hidrokarbureve. Sa më sipër, për subjektet që nuk kanë depozituar të dhënat në sektorin e të ardhurave në Bashkinë Belsh, konsiderohen si subjekte debitore në lidhje me pagesën për liçencimin (autorizimin) e tregtimit të hidrokarbureve, në vlerën **8,000,000 lekë** e cila përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Belsh. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me VKM nr. 170, date 25.4.2002 "Për përcaktimin e procedurave dhe te kushteve për dhënien e lejeve e te autorizimeve për tregtimin e naftës, gazit e nënprodukteve te tyre", paragrafi III *(Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe 150-162 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
**<u>11.1. Rekomandim</u>:** Bashkia Belsh, të kontabilizojë shumën e detyrimit **8,000,000 lekë** në ngarkim të subjekteve debitore, sipas listës së lënë nga KLSH dhe të kërkojë prej tyre arkëtimin e kësaj vlere, duke aplikuar masat shtrënguese ligjore si urdhër bllokimi në bankë apo vendosje të barrës siguruese.

**Menjëherë**

**12. Gjetje nga auditimi:** Në territorin e Bashkisë Belsh, ushtrojnë aktivitet peshkimi rreth 40 subjekte peshkimi, 2 subjekte grumbullimi të bimëve medicinale dhe 3 subjekte minerare ose inertesh, me të cilat Bashkisë Belsh nuk ka lidhur kontratë për shfrytëzimin e sipërfaqeve sipas lejeve minerare apo të tjera dhe se asnjëri prej këtyre subjekteve nuk ka kontratë me Bashkinë për shfrytëzimin e aseteve të saj. Pavarësisht se këto kontrata shfrytëzimi mund të jenë lidhur nga Ministritë e linjës apo institucione të tjera, në bazë të legjislacionit në fuqi, të ardhurat e përftuara nga përdorimi apo shfrytëzimi i pasurive të njësisë vendore duhet të derdhen në buxhetin e njësisë vendore.
Nga ana e bashkisë nuk është zhvilluar asnjë korrespondencë për të kërkuar informacion në institucionet përkatëse që merren me liçencimin apo kontraktimin e këtyre subjekteve *(Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe 150-162 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
**<u>12.1.Rekomandim</u>:** Bashkia Belsh, të zhvillojë korrespondencë me institucionet përkatëse në lidhje me evidentimin dhe plotësimin e regjistrave të saj me subjektet që zhvillojnë aktivitet duke shfrytëzuar asetet e Bashkisë në çfarëdolloj forme dhe të lidhë kontrata me këto subjekte, jo vetëm për të përfituar nga shfrytëzimi i këtyre pasurive, por edhe për t'i mbrojtur këto asete, florën dhe faunën e territorit të saj.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

**13. Gjetje nga auditimi:** Struktura e policisë bashkiake në Bashkinë Belsh nuk është krijuar si sektor më vete, me emërtimin përkatës sipas kërkesave ligjore. Ky sektor funksionon si Inspektoriat i Menaxhimit të Territorit dhe jo si Polici Bashkiake, në kundërshtim me ligjin nr.

8224, datë 15.5.1997 "Për organizimin dhe funksionimin e policisë të bashkisë dhe të komunës", i ndryshuar.

Emërimet e punonjësve të policisë bashkiake nuk janë bërë nëpërmjet komisionit të përzgjedhjes së kandidatëve, por nga Kryetari i Bashkisë Belsh, në kundërshtim me nenin 5 të ligjit të sipërpërmendur dhe nenit 11 të Rregullores së brendshme "TIP" të Policisë Bashkiake, miratuar me Urdhrin e Përbashkët të Ministrisë së Pushtetit Vendore dhe Ministrisë së Rendit Publik nr. 1, datë 17.04.2003 "Për miratimin e rregullores TIP të policisë bashkiake dhe të komunës". Për emërimet e kryera nuk është marrë në konsideratë kriteri i moshës, nuk ka asnjë të dhënë nëse punonjësit e policisë i janë nënshtruar ose jo betimit, në zbatim të nenit 6, të Rregullores së sipërpërmendur.

Me punonjësit e policisë bashkiake, nuk janë lidhur kontrata pune me afat mbi dy vjet sipas kërkesave në aktet ligjore dhe nënligjore të cituara më sipër *(Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe 150-162 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**13.1.Rekomandimi**: Nga Bashkia Belsh të merren masa për krijimin e strukturës së Policisë Bashkiake të pavarur nga drejtoritë e tjera. Në rastet e marrjes së punonjësve të rinj në punë të zbatohet procedura e përzgjedhjes nga komisioni i posaçëm, t'u nënshtrohen betimit sipas formulës së përcaktuar nga ligji, të respektohen kriteret e moshës, arsimit, kualifikimeve etj.

Punonjësit e Policisë Bashkiake t'i nënshtrohen trajnimeve dhe kualifikimeve, sipas përcaktimeve ligjore. Të realizohet lidhja e kontratave të punës me afat mbi dy vjeçar.

**Menjëherë**

**14. Gjetje nga auditimi:** Asetet e transferuara në pronësi të Bashkisë Belsh dhe NJA që përmbledh kjo bashki nuk janë marrë në dorëzim me procesverbale. Dokumentacioni dhe të dhënat përkatëse në lidhje me asetet e Bashkisë janë vënë në dispozicion me shkresa zyrtare nga AITPP-ja, nëpërmjet VKM-ve përkatëse. Në lidhje me asetet e Bashkisë Belsh, nga grupi i auditimit u konstatua se nuk janë zbatuar kërkesat e pikës 13 të VKM-së nr. 500, dt. 14.08.2001 "Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave ne njësitë e qeverisjes vendore", e cila përcakton se: "Pas regjistrimit në pronësi të ndërtesave administrative dhe të mjediseve përkatëse, bashkitë ose komunat kanë të drejtë dhe janë të detyruara të vendosin çdo aset në librin e llogarive, sipas rregullave kontabël, që zbatohen për qeverisjen vendore. Mbajtësi i mëparshëm i kësaj prone, nëse është i ndryshëm nga pronari i ri, duhet që, njëkohësisht, ta heqë këtë aset nga librat e tij kontabël. Ky transferim kontabël i asetit do të dokumentohet në aktin e veçantë të transferimit kontabël, të nënshkruar nga të dyja palët".

Gjithashtu nuk janë zbatuar edhe kërkesat e pikës 21 të po kësaj VKM-je, e cila parashikon: "Që nga çasti i marrjes së listës përfundimtare të pronës, që do të transferohet, çdo njësi e qeverisjes vendore është përgjegjëse për: a) mbajtjen e listës së inventarizimit të këtyre pronave; b) azhornimin në vazhdimësi të listës së inventarit pas regjistrimit, sa herë që merren prona të reja, jepen ose shiten, ose shfaqen interesa të palëve të treta, siç është dhënia me qira apo hipotekimi." (*Më hollësisht trajtuar në pikën 7, faqe 198-208 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**14.1.Rekomandim:** Bashkia Belsh, të marrë masa për funksionimin e komisioneve të ngritura me qëllim identifikimin në terren të gjendjes juridike të aseteve, marrjen në dorëzim, kolaudimin, vlerësimin, regjistrimin në ZVRPP dhe kontabilizimin e aseteve të qëndrueshme, sipas miratimeve me vendime të Këshillit të Ministrave.

**Menjëherë**

**15. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i Aktiveve në bilancin kontabël, u konstatua se në llogarinë 210 "Toka, troje, terrene", 211 "Pyje, kullota, plantacione" etj., vlera kontabël është e pandryshuar, pasi nuk është bërë asnjë regjistrim i ri në hipotekë dhe rrjedhimisht nuk janë bërë as regjistrimet përkatëse në kontabilitet. Gjithashtu, edhe llogari të tjera të aktivit janë të pandryshuara për të njëjtën arsye. Në llogarinë 217 "Kafshë pune e prodhimi" është e regjistruar vlera 288.000 lekë, e cila përfaqëson një donacion shpendësh të egra në vitin 2015 nga Këshilli i

Qarkut Elbasan. Kjo llogari nuk pasqyron drejt gjendjen, pasi është e pamundur që një njësi ekonomike të mbajë në kontabilitet shpendët e egra. Edhe sikur këto shpendë të ishin të mbikëqyrura dhe të kontrolluara nga bashkia, duhet të ishin regjistruar në llogarinë 334, "Kafshë në rritje e majmëri (*Më hollësisht trajtuar në pikën 7, faqe 198-208 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**15.1. Rekomandim:** Bashkia Belsh, të marrë masa për të evidentuar situatat inventariale të këtyre llogarie dhe të bëhen rregullimet përkatëse duke regjistruar dhe administruar me prioritet asetet që kanë interesa të veçanta kulturore, sportive etj., si dhe të rregullojë gjendjen e llogarisë 217 apo llogarive të tjera të së njëjtës natyrë.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

**16. Gjetje nga auditimi:** Nga Bashkia Belsh dhe ish Komunat, sot Njësi Administrative, nuk është bërë marrja në dorëzim me procesverbale e aseteve të qëndrueshme, nga institucionet e tjera në pronësi të të cilave kanë qenë këto asete, rrjedhimisht nuk është kryer identifikimi, inventarizimi fizik dhe regjistrimi në kontabilitet, nuk është aplikuar në ZVRPP Elbasan për regjistrimin e të gjitha aseteve dhe pasurive të tjera, veprime në kundërshtim me ligjin nr. 8744, datë 22.2.2001, "*Për pronat e paluajtshme të shtetit*", ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, "*Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin*", me pikat 20, 21 dhe 22, të VKM nr Nr. 500, datë 14.8.2001 "*Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore*", me pikat 37, 42-60, 74, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 "*Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik*".

Veprimet e mësipërme janë në shkelje të kërkesave të ligjit nr. 33-2012 "*Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme*", dhe UMF-së nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", kap. III, pika 30 *(Më hollësisht trajtuar në pikën 7, faqe 198-208 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**16.1. Rekomandim:** Bashkia Belsh të marrë masa për marrjen në dorëzim të aseteve, nëpërmjet komisioneve të ngritura, duke kryer vlerësimin, inventarizimin kontabël dhe fizik dhe të aplikohet në ZVRPP Elbasan për regjistrim e tyre.

Marrja në dorëzim e këtyre pronave dhe aseteve të qëndrueshme të bëhet me procesverbale të nënshkruara nga përfituesi Bashkia Belsh dhe nga institucionet qendrore si dorëzues.

Këto proces-verbale duhet të jenë shoqëruar me hartat përkatëse në zbatim të procedurave ligjore.

**Menjëherë**

**17. Gjetje nga auditimi:** Në fushën e aseteve, u konstatua se për të gjitha rastet me shënime si "e zënë forcërisht", "e zaptuar", etj., nuk ka pasur asnjë denoncim në organet kompetente të zbatimit të ligjit dhe nuk është ndërmarrë asnjë veprim nga ana e strukturave të Bashkisë Belsh, Policia Bashkiake, INUV-ja, etj., për lirimin e pronave dhe aseteve të zëna forcërisht për të vënë në posedim të Bashkisë këto pasuri, të cilat do t'i shërbenin funksionit të saj në shërbim të komunitetit.

Në territorin e Bashkisë Belsh nuk ka asnjë procedurë të kësaj natyre dhe rrjedhimisht nuk ka as procedura apo procese gjyqësore për këtë qëllim *(Më hollësisht trajtuar në pikën 7, faqe 198-208 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**17.1. Rekomandim:** Nga zyra juridike duhet të fillojnë procedura për ndjekjen në rrugë gjyqësore të problemeve me subjektet debitore dhe me personat që posedojnë padrejtësisht sipërfaqet e objekteve, trojeve, tokave bujqësore, kullotave, pyjeve, etj., pasuri të cilat duhet të ishin në shërbim të komunitetit.

**Menjëherë**

**18. Gjetje nga auditimi:** Bazuar në VKM-së nr. 886, datë 03.11.2010, u konstatua se në **110 raste në fushën e aseteve,** për sipërfaqen e përgjithshme të truallit prej **197.941 m$^2$**, prej të cilave sipërfaqe ndërtimi 9.098 m$^2$, sipërfaqe funksionale 14.314 m$^2$, troje të lira 152.955 m$^2$,

tokë arë 21.574 m$^2$, asetet janë në përdorim të të tretëve, persona privatë. Këto asete janë zënë forcërisht prej këtyre personave.
Duke llogaritur qiranë e munguar për ndërtesat dhe trojet funksionale për periudhën 01.01.2016 deri më 31.12.2017, në vijim të argumentimit të përdorur edhe në rekomandimin e lënë nga grupi i auditimit të mëparshëm të KLSH-së, sipas VKM-së nr. 54, datë 05.02.2014, "*Për përcaktimin e kritereve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore*", të ndryshuar, Kapitulli III, pika 1/a,b, u *konstatua një vlerë* ***të ardhura të munguara në shumën e përgjithshme 388,880,328 lekë, për buxhetin e Bashkisë Belsh,*** të ardhura të llogaritura vetëm për periudhën e auditimit, të cilat do të realizoheshin nëse do të ishin lidhur kontrata qiraje vetëm për trojet dhe tokat arë "të zëna forcërisht" apo "në përdorim nga të tretët" *(Më hollësisht trajtuar në pikën 7, faqe 198-208 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
**18.1. Rekomandim:** Bashkia Belsh, brenda hapësirave ligjore, të shohë mundësinë e arritjes së një marrëveshje me personat përkatës dhe në rast se kjo nuk arrihet, të bëhet denoncim në organet kompetente të zbatimit të ligjit dhe të veprohet në bashkëpunim me strukturat e Bashkisë Belsh, Policinë Bashkiake për lirimin e aseteve të zëna forcërisht dhe të vihen këto në posedim të Bashkisë si pasuri në shërbim të komunitetit.

**Menjëherë**

**19. Gjetje nga auditimi:**. Nga ish Komuna Fierzë (sot NJA e Bashkisë Belsh), në datën 03.08.2014 është lidhur kontratë qiraje, numër ska, me kompanisë **A.C. (sot T.A.)** për sipërfaqen e truallit 300 m $^2$ me çmimin 75 lekë/m$^2$, në vend të çmimit prej 100 lekë/m$^2$ . Për kohëzgjatjen e kontratës gusht 2014-dhjetor 2017 (41 muaj), nga aplikimi i gabuar i çmimit është shkaktuar një e ardhur e munguar në buxhet në vlerën **307,500 lekë** *(Më hollësisht trajtuar në pikën 7, faqe 198-208 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
**19.1. Rekomandim:** Bashkia Belsh, të marrë masa për rishikimin e kontratës së qerasë të truallit me kompaninë **T.A.** me synim vendosjen e çmimit të duhur të qerasë, si dhe të arkëtojë detyrimet e prapambetura **307,500 lekë** nga kjo kompani.

**Menjëherë**

**20. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i kontratave të qirave për tokën bujqësore shtetërore të pandara , u konstatua se janë konsideruar të lidhura gjithsej 107 kontrata qiraje me persona të ndryshëm për tokat bujqësore të pa ndara për sipërfaqen totale 925,990 m$^2$ ose 92.6 ha. Asnjë kontratë, përfshirë ato që janë të noterizuara nuk ka planin e biznesit ose të investimit.
Nga auditimi, u konstatua se në shumicën e rasteve nuk ka kontrata, nuk ka dokumentacion në dosje ose ka vetëm nga një skicë me shkrim dore, nuk janë zhvilluar procedurat e ankandit, nuk janë nënshkrimet e anëtarëve të bordit apo të komisionit të qiradhënies, kontratat nuk janë lidhur në prani të noterit, në kundërshtim me aktet ligjore dhe nënligjore të përmendura më sipër dhe me kërkesat e ligjit nr. 7850, datë 29.7.1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar. Kontrata të noterizuara janë vetëm 7 në ish Komunën Fierzë.
Nga mos pagesa e detyrimeve nga qiradhënia e tokave bujqësore shtetërore të pandara u konstatua e ardhur e munguar vlera totale **27,762,281 lekë, nga e cila** vlera **2,540,064 lekë** përbën vlerën e kontraktuar të qerasë dhe **vlera 22,222,217 lekë** përbën kamatë-vonesa sipas kontratave lidhur ndërmjet palëve *(Më hollësisht trajtuar në pikën 7, faqe 198-208 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
**20.1. Rekomandim:** Bashkia Belsh, të verifikojë ligjshmërinë e procedurave të qiradhënies së tokave bujqësore, (ankandet, vendimet e bordit, etj.), zbatimin e kërkesave kontraktuale në lidhje me kultivimet dhe mirëmbajtjen e këtyre tokave në përputhje me kushtet e kontratave. Të kontabilizojë shumën e detyrimit **24,762,281 lekë,** në ngarkim të 107 personave fizikë qiramarrës të tokave bujqësore të pandara, të kërkojë sipas ligjit arkëtimin e kësaj vlere, duke

ndjekur të gjitha procedurat ligjore administrative e gjyqësore. Për personat që nuk paguajnë detyrimet, të fillojnë procedurat për zgjidhjen e kontratës.

**Menjëherë**

**21. Gjetje nga auditimi:** Bashkia Belsh është audituar nga KLSH dhe me shkresën nr. 1103/7, datë 5.4.2016 janë dërguar rekomandimet për përmirësimin e gjendjes. Për masat e marra ka njoftuar KLSH-në me shkresën nr. 790/1, datë 28.4.2016 brenda 20 ditëve nga dërgimi i rekomandimeve. Zbatimi i rekomandimeve paraqitet si më poshtë
-Nga 18 masa për shpërblim dëmi, në vlerën totale 40,846,244 lekë janë zbatuar pjesërisht 8 masa, është arkëtuar vlera e dëmit 398,514 lekë, ose 1% e detyrimit.
Janë bërë 8 kërkesë padi në Gjykatën e Shkallës së Parë në fund të vitit 2017, me vonesa të pa justifikuara në kohë nga institucioni. Është ende pa arkëtuar vlera 40,447,730 lekë.
Në zbatim të rekomandimeve të KLSH, janë vendosur gjoba nga APP për 15 punonjës të Bashkisë në vlerën totale 970,000 lekë, e cila nuk është arkëtuar. Nga titullari dhe strukturat e tjera përkatëse të bashkisë nuk janë marrë masat e duhura për realizimin e rekomandimeve *(Më hollësisht trajtuar në pikën 1, faqe 24-30 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
**21.1. Rekomandim:** Kryetari i Bashkisë Belsh të hartojë plan pune të veçantë e të marrë të gjitha masat e duhura ligjore për zbatimin e rekomandimeve të pa zbatuara të KLSH në auditimin e mëparshëm, dërguar nga KLSH me shkresën nr. 1103/7, datë 5.4.2016, rikërkuar me shkresën 1113/113 datë 31.01.2017, trajtuar më hollësisht në Akt konstatimin nr 5, datë 08.03.2018 "Për zbatimin e rekomandimeve".

**Menjëherë**

## B.1 MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

Bazuar në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit" neni 15 germa (b) dhe (c) –*Të drejtat e KLSH* dhe mbështetur në nenet 98-102, të ligjit nr. 44/2015, datë 30.04.2015 "Kodi i procedurave administrative në Republikën e Shqipërisë", nenet 21-33, të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore" dhe pikën 93, të udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", **nga Titullari i Njësisë Publike**, të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore (Padi Gjyqësore), duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit. **Nëpunësi zbatues** të ndjekë procesin dhe të kryej regjistrimet e nevojshme kontabël përfundimtare, me qëllim shpërblimin e dëmit në vlerën **78,974,922 lekë,** si më poshtë:

**1. Gjetje nga auditimi:** Në objektin*"Projekti Ansambli Rilindja, Belsh"*, ku nga auditimi i projektit, specifikimeve teknike, dokumentacionit teknik të zbatimit, mbikëqyrjes dhe kolaudimit të punimeve të ndërtimit të administruara në dosjen teknike rezultoi se sheshi kryesor dhe pranë godinave, sipas projektit ishte parashikuar të shtrohej me gurë troktolit, ndërsa pllakat e gurit të shtruara në sheshin kryesor dhe pranë godinave, nuk janë pllaka prej guri troktolit (formacion shkëmbor magmatike), por një pjesë janë pllaka guri të marrë nga formacione shkëmbore ranore të imta (kategoria sedimentarë) dhe një pjesë janë pllaka guri të marrë nga formacione shkëmbore gëlqerore (kategoria sedimentarë).
Vlera totale e paguar në situacionin përfundimar për zërin "Shtrim me pllaka guri troktolit" është ***51,820,470 lekë pa TVSH,*** vlerë e cila është shpenzuar nga autoriteti kontraktor për një zë punimesh, i cili nuk është realizuar nga operatori ekonomik, sipas specifikimeve të projektit, preventivit dhe termave të referencës të dokumenteve standarde të tenderit. Në dosje nuk

administrohen çertifikatat e cilësisë së materialeve të përdorur, përfshirë edhe certifikatën e gurit troktolit.
Gjithashtu është audituar dhe objekti për realizimin e dy pedonaleve “Ndërtimi i pedonaleve dhe korsive të biçikletave, Liqeni Belsh” Nr.pa protokoll datë 18.07.2017, vazhdimësi e sheshit kryesor dhe korsive të biçikletave, të cilat janë pjesa integrale e “Projektit të Ansamblit Rilindja”, të realizuara nga po i njëjti sipërmarrës **“V.H.” SHPK**, ku u konstatua se në pjesën e majtë është realizuar me *“Trotuar me pllaka me përbërje guri gëlqeror”*, **identike** me pllakat e përdorura për një pjesë të sheshit kryesor dhe pranë godinave të “Ansamblit Rilindja”, por të realizuara me çmimin 3500 lekë/m$^2$. Diferenca e çmimit njësi është 6500 lekë/m$^2$ -3500 lekë/m2 =3000 lekë/m$^2$. Për volumin e punës 7972.38 m$^2$, diferenca në vlerë është ***23,917,140*** lekë pa TVSH. Në qoftëse do të ishte aplikuar i njëjti çmim edhe për pllakat e vendosura (të cilat nuk janë pllaka troktolite) në objektin “Projekti Ansambli Rilindja”, për këtë zë punimesh, ***autoriteti kontraktor do të kishte shpenzuar më pak 23,917,140 lekë pa T.V.SH , vlerë e cila përbën dëm ekonomik për Buxhetin e Shtetit dhe Njësisë Vendore.***
*(Më hollësisht trajtuar në pikën* III.4.b.*, faqe 125-127 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**1.1. Rekomandim:** Nga Bashkia Belsh të merren masa për arkëtimin e vlerës prej ***23,917,140*** **lekë pa TVSH**, nga operatori ekonomik ***“V.H.” SHPK***, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën pa nr. prot datë 19.07.2016, me objekt *“Projekti Ansambli Rilindja, Belsh”*, vlerë kjo e cila përbën dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si rrjedhojë e likuidimit të punimeve të kryera jo sipas specifikimeve teknike të projektit, preventivit dhe termave të referencës të dokumenteve standarde të tenderit. ***Në rast të zëvendësimit të pllakave të sheshit me pllaka konform specifikimeve teknike të projektit dhe dokumenteve të tenderit, ky dëm ekonomik shuhet.***

**Menjëherë**

**2. Gjetje nga auditimi:** Në objektin *“Projekti Ansambli Rilindja, Belsh”*, nga auditimi i projektit, dokumentacionit teknik të zbatimit, mbikëqyrjes dhe kolaudimit të punimeve të ndërtimit të administruara në dosjen teknike rezultuan diferenca në volume pune të likuiduara por të pakryera në fakt në vlerën 15,524,588 lekë, rritje fiktive e çmimit të zërave në vlerën 2,686,994 lekë dhe llogaritje të TVSH për pajisje në vlerën 228,000 lekë. Vlera totale e mësipërme prej **18,439,582 lekë pa TVSH** përbën dëm ekonomik për buxhetin e njësisë vendore. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. - prot., datë 19.07.2016 dhe kontratës shtesë nr. - prot., datë 10.02.2017 të lidhur mes Titullarit të Autoritetit Kontraktor Bashkia Belsh dhe OE **“V.H.” SHP**K *(Më hollësisht trajtuar në pikën 4.b, faqe 125-128 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**2.1. Rekomandim:** Nga Bashkia Belsh të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **18,439,582 lekë pa TVSH** nga operatori ekonomik **“V.H.” SHPK**, në cilësinë e sipërmarrësit sipas kontratës së punimeve nr. - prot datë 19.07.2016 dhe kontratës shtesë nr. - prot., datë 10.02.2017 me objekt *“Projekti Ansambli Rilindja, Belsh”*, vlerë kjo e cila përbën dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore si rrjedhojë e likuidimit të punimeve të pakryera në fakt, mos ndryshimit të çmimit të zërave në situacion sipas zërit faktik dhe llogaritjes së TVSH për pajisjet.

**Menjëherë**

**3. Gjetje nga auditimi:** Në objektin *“Sistemim Asfaltim Rruga Belsh - Qafë Shkallë”*, Belsh, nga auditimi i dokumentacionit teknik të zbatimit, mbikëqyrjes dhe kolaudimit të punimeve të ndërtimit të administruara në dosjen teknike rezultuan diferenca në volume pune të likuiduara

por të pakryera në fakt në vlerën **11,466,250 lekë pa TVSH** e cila përbën dëm ekonomik. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. - prot datë 11.10.2016 të lidhur midis Titullarit të Autoritetit Kontraktor Bashkia Belsh dhe OE **"V.H." SHPK** *(Më hollësisht trajtuar në pikën 4.b, faqe 130-133 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**<u>3.1. Rekomandim</u>:** Nga Bashkia Belsh të merren masa për arkëtimin e vlerës **11,466,250 lekë pa TVSH** nga operatori ekonomik **"V.H." SHPK**, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën nr. - prot datë 11.10.2016 me objekt *"Sistemim Asfaltim Rruga Belsh-Qafë Shkallë"*, vlerë kjo e cila përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore si rrjedhojë e likuidimit të punimeve të pakryera në fakt apo prej mos ndryshimit të zërave në situacion sipas zërit faktit.

**Menjëherë**

**4. Gjetje nga auditimi:** Në objektin *"Ndërtim, sistemim dhe asfaltim, rruga Trojas", Belsh*, nga auditimi i projektit, dokumentacionit teknik të zbatimit, mbikëqyrjes dhe kolaudimit të punimeve të ndërtimit të administruara në dosjen teknike rezultuan diferenca në volume pune të likuiduara por të pakryera në fakt, në vlerën **9,306,120 lekë pa TVSH**. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve pa nr. prot., datë 18.04.2017, të lidhur mes Titullarit të Autoritetit Kontraktor Bashkia Belsh dhe BOE **"S.N.P.& E." SHPK** *(Më hollësisht trajtuar në pikën 4.b, faqe 146-149 të Raportit Përfundimtar).*

**<u>4.1. Rekomandim</u>:** Nga Bashkia Belsh të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **9,306,120 lekë pa TVSH**, nga BOE **"S.N.P.& E." SHPK**, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën pa nr. prot datë 18.04.2017, me objekt *"Ndërtim, sistemim dhe asfaltim, rruga Trojas", Belsh,* vlerë kjo e cila përbën dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si rrjedhojë e likuidimit të punimeve të pakryera në fakt.

**Menjëherë**

**5. Gjetje nga auditimi:** Në objektin *"Ndërtimi i pedonaleve dhe korsive të biçikletave, Liqeni Belsh"*, nga auditimi i projektit, dokumentacionit teknik të zbatimit, mbikëqyrjes dhe kolaudimit të punimeve të ndërtimit të administruara në dosjen teknike rezultuan diferenca në volume pune të likuiduara por të pakryera në fakt në vlerën 1,916,128 lekë, si dhe rritje fiktive e çmimit të zërave në vlerën 1,090,577 lekë. Në total vlera prej **3,006,705 lekë pa TVSH** përbën dëm ekonomik. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve pa nr. prot datë 18.07.2017, të lidhur mes Titullarit të Autoritetit Kontraktor Bashkia Belsh dhe OE **"V.H." SHPK** *(Më hollësisht trajtuar në pikën 4.b, faqe 142-145 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**<u>5.1. Rekomandim</u>:** Nga Bashkia Belsh të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **3,006,705 lekë pa TVSH**, nga operatori ekonomik ***"V.H." SHPK***, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën pa nr. prot datë 18.07.2017, me objekt *"Ndërtimi i pedonaleve dhe korsive të biçikletave, Liqeni Belsh"*, vlerë kjo e cila përbën dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si rrjedhojë e likuidimit të punimeve të pakryera në fakt.

**Menjëherë**

**6. Gjetje nga auditimi:** Në objektin *"Rikualifikim Urban i fasadave të qendrës", Belsh*, nga auditimi i dokumentacionit teknik të zbatimit, mbikëqyrjes dhe kolaudimit të punimeve të ndërtimit të administruara në dosjen teknike rezultuan diferenca në volume pune të likuiduara por të pakryera në fakt në vlerën **1,183,595 lekë pa TVSH.** Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. - prot datë 11.09.2017 të lidhur mes Titullarit të Autoritetit Kontraktor Bashkia Belsh dhe OE "**F.C.**" **SHPK** *(Më hollësisht trajtuar në pikën 4.b, faqe 139-141 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**6.1. Rekomandim:** Nga Bashkia Belsh të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **1,183,595 lekë pa TVSH** nga operatori ekonomik **"F.C." SHPK**, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën nr. - prot datë 11.09.2017 me objekt *"Rikualifikim Urban i fasadave të qendrës", Belsh*, vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore si rrjedhojë e likuidimit të punimeve të pakryera në fakt apo prej mos ndryshimit të zërave në situacion sipas zërit faktit.

**Menjëherë**

**7. Gjetje nga auditimi**: Në objektin *"Përmirësimi i kushteve të banimit të komunitetit Rom/Egjiptian", Belsh,* nga auditimi i dokumentacionit teknik të zbatimit, mbikëqyrjes dhe kolaudimit të punimeve të ndërtimit të administruara në dosjen teknike rezultuan diferenca në volume pune të likuiduara por të pakryera në fakt në vlerën **70,559 lekë pa TVSH.** Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. - prot datë 15.08.2016 të lidhur mes Titullarit të Autoritetit Kontraktor Bashkia Belsh dhe OE "**F.**" **SHPK** *(Më hollësisht trajtuar në pikën 4.b, faqe 137-138 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**7.1. Rekomandim:** Nga Bashkia Belsh të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **70,559 lekë pa TVSH,** nga operatori ekonomik ***"F."* SHPK** në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën nr. - prot datë 15.08.2016 me objekt *"Përmirësimi i kushteve të banimit të komunitetit Rom/Egjiptian", Belsh,* vlerë kjo e cila përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore si rrjedhojë e likuidimit të punimeve të pakryera në fakt apo prej mos ndryshimit të zërave në situacion sipas zërit faktit.

**Menjëherë**

**8. Gjetje nga auditimi:** Në tenderin me objekt "*Sistemim asfaltim rruga Belsh-Qafshkallë*", me fond limit 57,999,000 lekë pa TVSH zhvilluar në vitin 2016, KVO ka kualifikuar dhe shpallur fitues OE "**V.H." SHPK**, me vlerë të ofertës ekonomike 50,403,215 lekë pa TVSH i cili nuk i plotëson kriteret e vendosura në DST dhe, ka s'kualifikuar padrejtësisht BOE "**A.K. SHPK &B-I" SHPK**", me vlerë të ofertës ekonomike 39,948,344 lekë pa TVSH i cili plotëson kriteret e vendosura në DST, duke shkaktuar **dëm ekonomik në vlerën 10,454,871 lekë,** si diferencë midis dy ofertave (50,403,215 -39,948,344). Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 1, pika b, d, dh; nenin 2, pika a, c; nenin 53 pika 3; 5; nenin 55, të ligjit 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, nenin 56 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" *(Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 67-71 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**8.1. Rekomandim**: Bashkia Belsh, të marrë masa dhe të ndjekë të gjitha procedurat e nevojshme ligjore për arkëtimin e vlerës **10,454,871 lekë** nga personat e mëposhtëm:

**z.H.T.**, me detyrë drejtor i bujqësisë, në cilësinë e kryetarit të KVO, për vlerën **3,484,957 lekë**;

**z. H.Xh.**, me detyrë ish përgjegjës i urbanistikës, ndërprerë marrëdhëniet e punës, në cilësinë e anëtarit të KVO, për vlerën **3,484,957 lekë**;

**zj. I.H.**, me detyrë ish juriste, ndërprerë marrëdhëniet e punës, në cilësinë e anëtarit të KVO, për vlerën **3,484,957 lekë**.

**Menjëherë**

**9. Gjetje nga auditimi:** Në tenderin me objekt "*Skema e Ujitjes e Fushës Cestie (Degëzimi Kosove) Pjesshëm*", me fond limit 11,378,173 lekë pa TVSH zhvilluar në vitin 2017, KVO ka kualifikuar dhe shpallur fitues BOE **"F." SHPK &''Sh.''SHPK**, me vlerë të ofertës ekonomike 10,094,975 lekë pa TVSH i cili nuk i plotëson kriteret e vendosura në DST dhe, ka s'kualifikuar padrejtësisht OE **"A."SHPK** me vlerë të ofertës ekonomike 9,346,275 lekë pa TVSH i cili plotëson kriteret e vendosura në DST, duke shkaktuar **dëm ekonomik në vlerën 748,700 lekë,** si diferencë midis dy ofertave (10,094,975 - 9,346,275). Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 1, shkronjat (b, d, dh) nenin 2, shkronjat ( a, c), nenin 53 pika 3; nenin 55, të ligjit 9643, datë 20.11.2006 "*Për prokurimin publik*", i ndryshuar, nenin 56 të VKM nr.

914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (*Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 105-107 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**9.1. Rekomandim:** Bashkia Belsh, të marrë masa dhe të ndjekë të gjitha procedurat e nevojshme ligjore për arkëtimin e vlerës **748,700 lekë** nga personat e mëposhtëm:

z. **A.N.**, me detyrë drejtor ekonomik, në cilësinë e kryetarit të KVO, për vlerën **249,576 lekë**;

z. **E.B.**, me detyrë përgjegjës i urbanistikës, në cilësinë e anëtarit të KVO, për vlerën **249,576 lekë**;

zj. **I.H.**, me detyrë ish juriste, ndërprerë marrëdhëniet e punës, në cilësinë e anëtarit të KVO, për vlerën **249,576 lekë**;

**Menjëherë**

**10. Gjetje nga auditimi:** Në tenderin me objekt “*Blerje Automjet transporti inertesh dhe transporin e eskavatorit me zinxhira*”, me fond limit 4,100,000 lekë pa TVSH zhvilluar në vitin 2017, KVO ka kualifikuar dhe shpallur fitues OE **“F.” SHPK**, me vlerë të ofertës ekonomike 4,090,000 lekë pa TVSH, i cili nuk i plotëson kriteret e vendosura në DST dhe ka s’kualifikuar padrejtësisht OE **“P.I.” SHPK**, me vlerë të ofertës ekonomike 3,890,000 lekë pa TVSH i cili plotëson kriteret e vendosura në DST, duke shkaktuar **dëm ekonomik në vlerën 200,000 lekë,** si diferencë midis dy ofertave (4,090,000-3,890,000). Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 1, shkronjat (b, d, dh) nenin 2, shkronjat ( a, c), nenin 53 pika 3; ; nenin 55, të ligjit 9643, datë 20.11.2006 “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar, nenin 56 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” *(Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 87-89 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**10.1. Rekomandim:** Bashkia Belsh, të marrë masa dhe të ndjekë të gjitha procedurat e nevojshme ligjore për arkëtimin e vlerës **200,000 lekë** nga personat e mëposhtëm:

z. **A.N.**, me detyrë drejtor ekonomik, në cilësinë e kryetarit të KVO, për vlerën **33,333 lekë**.

z.**Q.R.**, me detyrë përgjegjës i shërbimeve, në cilësinë e anëtarit të KVO, për vlerën **33,333 lekë**.

zj.**I.H**. me detyrë ish juriste, ndërprerë marrëdhëniet e punës, në cilësinë e anëtarit të KVO, për vlerën **33,333 lekë**.

z. **D.M.**, me detyrë përgjegjës i zyrës juridike, në cilësinë e kryetarit të komisionit të shqyrtimit të ankesës së operatorit ekonomik të skualifikuar, për vlerën **33,333 lekë.**

Zj.**R.H.**, me detyrë juriste, në cilësinë e anëtarit të komisionit të shqyrtimit të ankesës së operatorit ekonomik të skualifikuar, për vlerën **33,333 lekë.**

Z. **P.T.**, me detyrë specialist shërbimesh, në cilësinë e anëtarit të komisionit të shqyrtimit të ankesës së operatorit ekonomik të skualifikuar, për vlerën **33,333 lekë.**

**Menjëherë**

**11. Gjetje nga auditimi:** Në Bashkinë Belsh për periudhën 2016-2017 në shpenzimet për paga, janë bërë pagesa të kundërligjshme për 16 punonjës në vlerën totale **181,400 lekë**, dëm ekonomik për buxhetin e njësisë vendore, në kundërshtim me kërkesat e pikës 12, paragrafi V dhe lidhjes 2; 7 të VKM nr. 1619, datë 02.07.2008 “*Për klasifikim e funksioneve e grupimin e njësive të qeverisjes vendore, për efekt page dhe caktimin e kufijve të pagave të punonjësve të qeverisjes vendore*” i ndryshuar me VKM nr.518, datë 16.08.2012, VKM nr.586, datë 17.07.2013, VKM nr.165, datë 02.03.2016 *(Më hollësisht trajtuar në pikën3, faqe 34-35 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**11.1. Rekomandim**: Bashkia Belsh, të marrë masa dhe të ndjekë të gjitha procedurat e nevojshme ligjore për arkëtimin e vlerës 181,400 lekë sipas listës së mëposhtme: **M.Xh**.për vlerën 12,458 lekë, **E.B.**për **G.H.**për vlerën 16,610 lekë, **G.C.** për vlerën 12,458 lekë, **O.M.** për vlerën 12,458 lekë, **K.K.** për vlerën 12,458 lekë, **D.M.** për vlerën 8,305 lekë, **H.B.** për vlerën 8,305 lekë, **A.K.** për vlerën 12,458 lekë, **A.D.** për vlerën 12,458 lekë, **J.D.** për vlerën 8,305 lekë, **F.B.** për vlerën 4,153 lekë, **E.H.** për vlerën 4,153 lekë, **V.C.** për vlerën 16,432 lekë.

**Menjëherë**

**B2. MASA PËR ELIMIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE.**

Për shkak të mos zbatimit të kërkesave ligjore gjatë zhvillimit të procedurave të prokurimit publik, duke kualifikuar operatorë ekonomikë të cilët nuk plotësojnë kriteret e DST, janë përdorur fonde publike në kundërshtim me kërkesat ligjore, pa ekonomicitet, eficence dhe efektivitet në vlerën 286,080,460 lekë në fushën e procedurave të prokurimit publik, e cila përbën 1/3 e numrit të tenderave të zhvilluar, ose 52% e vlerës së kontratave të lidhura.
Nga auditimi i procedurave të prokurimit publik të zhvilluara, u konstatuan se 8 procedura prokurimi janë kryer në kundërshtim me nenin 2 "Parimet e përzgjedhjes", nenin 55 "Kriteret e përcaktimit të ofertës fituese", nenin 24 "Anulimi i një procedure prokurimi" pikën 5 të nenit 53 "Shqyrtimi i ofertave", të ligjit 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, nenin 56 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik". Operatorët ekonomik janë shpallur fitues edhe pse kanë mangësi në dokumentacionin e paraqitur sipas kërkesave të DST**,** të hartuara nga Njësia e Prokurimit e të miratuara nga Titullari i Autoritetit Kontraktor, duke mos garantuar përmbushjen me cilësi të kontratës në këto tendera, për shkak të mos përmbushjes së kritereve të vendosura në DST. Shkeljet e konstatuara në tendera në mënyrë të detajuar si më poshtë vijon:

**1. Gjetje nga auditimi: 1.1.** Në tenderin me objekt "*Projekti i Asamblit Rilindja, Belsh",* me fond limit 150,668,075 lekë pa TVSH zhvilluar në vitin 2016, është kualifikuar dhe shpallur fitues OE ''**V.H.**" **SHPK**, me vlerë të ofertës ekonomike 149,964,467 lekë, i cili nuk plotëson kriteret e vëndosura në DST. Tenderi duhej anulluar dhe duhej zhvilluar proçedurë e re. Shpallja fitues e operatorit ekonomik i cili nuk plotëson kriteret e DST, ka shkaktuar **përdorim të fondeve publike pa ekonomicitet, eficencë dhe efektivitet, në kundërshtim me kërkesat ligjore, në vlerën 149,964,467 lekë.**
**1.2.** Në tenderin me objekt "Kontenier pastrimi*",* me fond limit **2,153,060** lekë pa TVSH zhvilluar në vitin 2016, është kualifikuar dhe shpallur fitues OE **''B.''SHPK**, me vlerë të ofertës ekonomike **2,002,000** lekë, i cili nuk plotëson kriteret e DST. Tenderi duhej anulluar dhe duhej zhvilluar proçedurë e re. Shpallja fitues e operatorit ekonomik i cili nuk plotëson kriteret e DST, ka shkaktuar **përdorim të fondeve publike pa ekonomicitet, eficencë dhe efektivitet, në kundërshtim me kërkesat ligjore, në vlerën e kontratës 2,002,000 lekë.**
**1.3.** Në tenderin me objekt "*Rikonstruksion i Godinës Bashkisë Belsh*", me fond limit 1,401,255 lekë zhvilluar në vitin 2016 është kualifikuar dhe shpallur fitues OE **"F." SHPK** me vlerë të ofertës ekonomike 1,334,040 lekë, i cili nuk plotëson kërkesat e DST. Shpallja fitues e operatorit ekonomik i cili nuk plotëson kriteret e DST, ka shkaktuar **përdorim të fondeve publike pa ekonomicitet, eficencë dhe efektivitet, në kundërshtim me kërkesat ligjore në vlerën e kontratës 1,334,040 lekë**.
**1.4.** Në tenderin me objekt "*Blerje automjet shërbimi për aparatin",* me fond limit 2,083,000 lekë zhvilluar në vitin 2016 është kualifikuar dhe shpallur fitues OE **"S." SHPK** me vlerë të ofertës ekonomike 1,990,000 lekë, i cili nuk plotëson kërkesat e DST. Tenderi duhet të ishtë anulluar dhe suhet të ishte zhvilluar procedurë e re. Shpallja fitues e operatorit ekonomik i cili nuk plotëson kriteret e DST, ka shkaktuar **përdorim të fondeve publike pa ekonomicitet, eficencë dhe efektivitet, në kundërshtim me kërkesat ligjore, në vlerën e kontratës 1,990,000 lekë.**

**1.5.** Në procedurën e prokurimit me objekt "*Rikualifikimi urban i fasadave të Qëndrës Belsh",* me fond limit 14,301,064 lekë pa TVSH zhvilluar në vitin 2017, është kualifikuar dhe shpallur fitues BOE **"F.C.& V.H." SHPK**, me vlerë të ofertës ekonomike 13,906,036 lekë, i cili nuk plotëson kriteret e DST. Tenderi duhej anulluar dhe duhej zhvilluar proçedurë e re. Kualifikimi dhe shpallja fitues e operatorit ekonomik i cili nuk plotëson kriteret e DST, është bërë në kundërshtim me kërkesat ligjore, duke shkaktuar **përdorim të fondeve publike pa ekonomicitet, eficencë dhe efektivitet**, **në vlerën e kontratës 13,906,036 lekë.**
**1.6**. Në procedurën e prokurimit me objekt "*Ndërtim i pedonales dhe korsisë së bicikletave Liqeni Belsh*", me fond limit 46,098,031 lekë pa TVSH zhvilluar në vitin 2017, është kualifikuar dhe shpallur fitues OE **"V.H." SHPK**, me vlerë të ofertës ekonomike 45 919 904 lekë, i cili nuk plotëson kriteret e DST. Tenderi duhej anulluar dhe duhej zhvilluar proçedurë e re. Kualifikimi dhe shpallja fitues e operatorit ekonomik i cili nuk plotëson kriteret e DST, është bërë në kundërshtim me kërkesat ligjore, duke shkaktuar **përdorim të fondeve publike pa ekonomicitet, eficencë dhe efektivitet në vlerën e kontratës 45,919,904 lekë**.
**1.7.** Në tenderin me objekt "*Ndërtim sistemim,asfaltim rruga e Trojas*", me fond limit 61 016 181 lekë zhvilluar në vitin 2017 është kualifikuar dhe shpallur fitues OE **"S.N.P." SHPK** me vlerë të ofertës ekonomike **60,964,013** lekë, i cili nuk plotëson kërkesat e DST. Tenderi duhej të ishte anulluar dhe të zhvillohej procedurë e re. Kualifikimi dhe shpallja fitues e operatorit ekonomik i cili nuk plotëson kriteret e DST, është bërë në kundërshtim me kërkesat ligjore, duke shkaktuar **përdorim të fondeve publike pa ekonomicitet, eficencë dhe efektivitet**, **në vlerën e kontratës 60,964,013 lekë.**
**1.8.** Në tenderin me objekt "*Blerje karburanti për vitin 2017*", me fond limit 10,000,000 lekë, zhvilluar në vitin 2017, është kualifikuar dhe shpallur fitues OE "**V.H." SHPK** me marxhë fitimi 14%, i cili nuk plotëson kërkesat e DST. Tenderi duhej të anullohej. Kualifikimi dhe shpallja fitues e operatorit ekonomik i cili nuk plotëson kriteret e DST, është bërë në kundërshtim me kërkesat ligjore, duke shkaktuar **përdorim të fondeve publike pa ekonomicitet, eficencë dhe efektivitet**, **në vlerën e kontratës 10,000,000 lekë**.
**1.1. Rekomandim:** Bashkia Belsh, nëpërmjet strukturave përkatëse, të nxjerrë përgjegjësitë dhe të marrë masa të menjëhershme për eliminimin e praktikave të kualifikimit dhe shpalljes fitues të operatorëve ekonomike në kushtet e mosplotësimit të kritereve të miratuara në DST, pasi operatorët ekonomik të cilët nuk plotësojnë kriteret e vendosura nga autoriteti kontraktor, nuk garantojnë cilësinë e punës, mallit dhe shërbimit.

**Menjëherë dhe në vazhdimësi**

## C. MASA ADMINISTRATIVE

### C.1. Për Agjencinë e Prokurimit Publik (APP)

**I.** Referuar parregullsive dhe shkeljeve të ndryshme të konstatuara në procedurat e prokurimeve me vlerë të lartë për periudhën 01.01.2016 deri më 31.12.2017, si dhe përgjegjësisë individuale të evidentuar dhe pasqyruar në Raportin Përfundimtar të Auditimit, bazuar në nenet 13 dhe 72 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, "Për prokurimin publik", i ndryshuar, të ligjit nr. 10279, datë 20.5.2010 "Për kundërvajtjet administrative" dhe bazuar në nenin 15 shkronjat (c dhe ç) dhe nenin 30 të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014, "Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", **i rekomandojmë Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Prokurimit Publik**, të vlerësojë shkeljet e konstatuara, duke vendosur marrjen e masave administrative (dënim me gjobë) në raport me shkeljet e konstatuara në procedurat e prokurimeve publike, apo

rekomandimin e Autoritetit Kontraktor (për marrjen e masave disiplinore), ndaj **12 punonjësve**, për procedurat e prokurimit, si më poshtë:

**1. A.T.**, me detyrë kryetar i Bashkisë Belsh, në cilësinë e titullarit të autoritetit kontraktor, për shkeljet e mëposhtme:
Për mos zbatim të ligjit 9643, datë 20.11.2006 "*Për prokurimin publik*", i ndryshuar, nenin 1 "Objekti dhe qëllimi", pika 1, 2/a/b/c/ç/dh, nenin 2, "Parimet e përzgjedhjes", nenin 33 "Procedura me negocim, pa shpallje paraprake të njoftimit"; Për mos zbatim të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", neni 36 "Procedura me negocim, pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës", neni 56 "Titullari i autoritetit kontraktor ose zyrtari i autorizuar", në tenderin me objekt "*Shtese kontrate për Projektin Rilindja Belsh (Belsh Qendër-Kryqëzimi Qafshkallë)*", me fond limit 29,166,660 lekë, zhvilluar në datën 07.02.2017. AK ka realizuar këtë objekt si shtesë kontrate, nëpërmjet procedurës së prokurimit "Me negocim pa shpallje paraprake", duke mos ekzistuar asnjë rrethanë ligjore për të argumentuar këtë procedurë.
Për sa më lartë ngarkohet me përgjegjësi titullari i AK z. **A.T.**, si personi i vetëm në përcaktimin e procedurës së prokurimit dhe lidhjen e kontratës me kontraktonin.

***Për 4 anëtarët e komisionit të vlerësimit të ofertave (KVO):***
**2. H.T.**, me detyrë drejtor i bujqësisë në Bashkinë Belsh, në cilësinë e kryetarit të komisionit të vlerësimit të ofertave (KVO);
**3.A.N.**, me detyrë drejtor ekonomik në cilësinë e anëtarit të KVO;
**4. E.B.**, me detyrë përgjegjës i urbanistikës, në cilësinë e anëtarit të KVO;
**5.E.M.**, me detyrë shefe kabineti, në cilësinë e anëtarit të KVO, *për shkeljet e mëposhtme të përbashkëta dhe individuale:*

Për mos zbatim të ligjit 9643, datë 20.11.2006 "*Për prokurimin publik*", i ndryshuar, nenin 1 pika b/d/dh, nenin 2 pika a/b/c; nenin 46 "Kualifikimi i ofertuesve", pika 1, nenit 53, pika 3 dhe 5, nenit 55, pika 1 dhe 5, germa a, në 4 raste, me pasojë **dëm ekonomik në vlerën 10,454,871 lekë** dhe **përdorim të fondeve publike pa ekonomicitet, efiçencë dhe efektivitet**, **në vlerën totale 286,080,460 lekë**, në tenderat e mëposhtëm:
- Në tenderin me objekt "*Sistemim asfaltim rruga Belsh-Qafshkallë*", me fond limit 57,999,000 lekë pa TVSH zhvilluar në datën 15.09.2016, kanë kualifikuar dhe shpallur fitues OE **"V.H." SHPK** me vlerë të ofertës ekonomike 50,403,215 lekë pa TVSH i cili nuk i plotëson kriteret e vendosura në DST me pasojë **dëm ekonomik në vlerën 10,454,871 lekë.**
- Në tenderin me objekt "Skema Ujitjes e Fushes Cestie (Degëzimi Kosovë) Pjesshëm", me fond limit 11,378,173 lekë pa TVSH zhvilluar në datën 28.03.2017, është kualifikuar dhe shpallur fitues BOE **"F." & ''Sh.''SHPK**, me vlerë të ofertës ekonomike 10,094,975 lekë pa TVSH i cili nuk i plotëson kriteret e vendosura në DST, me pasojë **dëm ekonomik në vlerën 748,700 lekë**.
- Në tenderin me objekt "Blerie Automjet transporti Inertesh dhe Transporin e Eskavatorit me Zinxhira", me fond limit 4,100,000 lekë pa TVSH zhvilluar në datën 05.09.2017, është kualifikuar dhe shpallur fitues OE **"F." SHPK**, me vlerë të ofertës ekonomike 4,090,000 lekë pa TVSH i cili nuk i plotëson kriteret e vendosura në DST, me pasojë **dëm ekonomik në vlerën 200,000 lekë**.
Në tenderat e mëposhtëm janë kualifikuar operatorë ekonomik të cilët nuk plotësojnë kriteret e vendosura në DST, e si rezultat është shkaktuar **përdorim i fondeve publike pa ekonomicitet, efiçencë dhe efektivitet** në vlerën e ofertës fituese, për arsye se operatorët ekonomik nuk garantojnë kryerjen me sukses dhe me cilësi të kontratës. Në të gjitha procedurat e mëposhtme tenderi duhej anulluar dhe duhej zhvilluar procedurë e re:

- Në procedurën e prokurimit me objekt “Projekti i Asamblit Rilindja, Belsh”, me fond limit 150,668,075 lekë pa TVSH zhvilluar në vitin 2016.
- Në tenderin me objekt “Blerje karburanti gazoil për vitin 2016”, zhvilluar në datën 29.02.2016 me fond limit 4,200,000 lekë.
- Në tenderin me objekt “Kontenier pastrimi*”,* me fond limit 2,153,060 lekë pa TVSH zhvilluar në datën 14.07.2016.
- Në tenderin me objekt “Ndërtim sistemim, asfaltim rruga e Trojas”, me fond limit 61,016,181 lekë zhvilluar në datën 06.03.2017.
- Në tenderin me objekt “Ndërtim i pedonales dhe korsisë së biçikletave Liqeni Belsh”, me fond limit 46,098,031 lekë pa TVSH zhvilluar në vitin 2017.
- Në tenderin me objekt “Rikualifikimi urban i fasadave të Qendrës Belsh”, me fond limit 14,301,064 lekë pa TVSH zhvilluar në datën 07.08.2017.
- Në tenderin me objekt “Blerje karburanti për vitin 2017”, me fond limit 10,000,000 lekë zhvilluar në vitin 2017.
-Në tenderin me objekt “Rikonstruksion i Godinës Bashkise Belsh”, me fond limit 1,401,255 lekë zhvilluar në datën 15.08.2016.

*<u>Për 7 anëtarët e komisionit të hartimit të DST dhe specifikimeve teknike</u>*:
**6. Q.R.**, me detyrë përgjegjës i shërbimeve, në cilësinë e anëtarit të komisionit të hartimit të DST dhe specifikimeve teknike;
**7. H.B.**, me detyrë jurist, në cilësinë e anëtarit të komisionit të hartimit të DST dhe specifikimeve teknike;
**8. D.B.**, me detyrë përgjegjës i zyrës juridike, në cilësinë e anëtarit të komisionit të hartimit të DST dhe specifikimeve teknike;
**9. I.R.**, me detyrë inspektore finance, në cilësinë e anëtarit të njësisë së prokurimit dhe hartimit të DST;
**10. A.A.**, me detyrë inspektore urbanistikës, në cilësinë e anëtarit të njësisë së prokurimit dhe hartimit të DST;
**11.E.H.**me detyrë specialist i kadastrës, në cilësinë e anëtarit të komisionit të hartimit të specifikimeve teknike;
**12. E.B.**, me detyrë përgjegjës i urbanistikës, në cilësinë e anëtarit të komisionit të hartimit të DST dhe specifikimeve teknike, *<u>për shkeljet e përbashkëta dhe individuale në procedura prokurimi si më poshtë:</u>*

Për mos zbatim të ligjit 9643, datë 20.11.2006 “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar, nenin 1, “Objekti dhe qëllimi”, pika 2, germa c, ç dhe d, neni 20, “Mos diskriminimi”; Për mos zbatim të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 61, pika 2, paragrafi 2, në 5 tenderat e mëposhtëm:
*1) Në tenderin me objekt “Shërbimi i Pastrimit të Qytetit”, zhvilluar në datën 07.09.2016.*
*2) Në tenderin me objekt “Rikonstruksion i Godinës Bashkise Belsh”, zhvilluar në datën 15.08.2016.*
*3)* Në tenderin me objekt *“Sistemim, asfaltim rrugët e brendshme te fshatrave te Bashkise Belsh” zhvilluar në vitin 2017.*
*d)* Në tenderin me objekt *“Ndërtim sistemim,asfaltim rruga Trojas” zhvilluar në vitin 2017.*
*4)* Në tenderin me objekt *“Skema Ujitjes e Fushes Cestie (Degezimi Kosove) Pjesshem”,* zhvilluar në vitin 2017.
*5) Në tenderin me objekt “Rikualifikimi urban i fasadave të Qendrës Belsh”, zhvilluar në datën 07.08.2017.*

## D. <u>MASA DISIPLINORE</u>

**D.1. Për punonjësit të cilët janë pjesë e Shërbimit Civil.**
Në mbështetje të shkronjës (c) neni 15 -Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", në zbatim të nenit 58, "llojet e masave disiplinore" të ligjit nr. 152/2013 datë 30.05.2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar me ligjin nr. 178/2014, datë 18.12.2014, VKM nr. 115, datë 05.03.2014 "Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil" dhe, nenin 64 shkronjën g, të ligjit nr. 139/2015,datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", **i rekomandojmë** Kryetarit së Bashkisë Belsh, që ti kërkojë Komisionit Disiplinor të fillojnë procedurat për dhënien e masës disiplinore:

**"Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në dy vjet", për 1 punonjës:**
**1. R. J.,** me detyrë përgjegjëse e sektorit të të ardhurave, *<u>për shkeljet e mëposhtme:</u>*
- Për mos ndjekje të procedurave ligjore për arkëtimin e detyrimeve nga subjektet debitor, në kundërshtim me kërkesat e Kreut XI-*Mbledhja me forcë e detyrimit tatimor,* të ligjit nr. 9920 datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", duke krijuar të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë në vlerën 5.8 milion lekë nga mospagesa e taksave dhe tarifave vendore nga bizneset private dhe 54 milion lekë nga mos vjelja e taksës së tokës bujqësore.
- Për mos nxjerrje të njoftim vlerësimi për arkëtimin e taksave familjare, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar neni 23 dhe Udhëzimit Plotësues të buxhetit të Ministrisë Financave nr. 03, datë 17.01.2014 "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2014", pika 52.
- Për mos krijimin e regjistrit për taksapaguesit familjar në Bashkinë Belsh, në kundërshtim me pikën 7, neni 4 të ligjit 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore" i ndryshuar.

Për punonjësit e tjerë të cilët janë atakuar në aktet e konstatimit dhe raportin përfundimtar, nuk është dhënë masë disiplinore në këtë rubrikë, për të mos krijuar mbivendosje masash, për arsye se këta punonjës janë të angazhuar në komisionin e vlerësimit të ofertave, komisionin e njësisë së prokurimit, komisionin e hartimit të dokumenteve të tenderit dhe specifikimeve teknike dhe, për shkeljet e konstatuara emrat e tyre i janë propozuar për masë Agjensisë së Prokurimit Publik në rubrikën C.1 "Masa administrative për APP". Në varësi të masave që do të jap APP, do të vazhdohet me propozimet e KLSH.
Lista e punonjësve si më poshtë:
1. **Q.R**., me detyrë përgjegjës i shërbimeve, në cilësinë e anëtarit të komisionit të hartimit të DST dhe specifikimeve teknike;
2. **H.B**., me detyrë jurist, në cilësinë e anëtarit të komisionit të hartimit të DST dhe specifikimeve teknike;
3. **D.B**., me detyrë përgjegjës i zyrës juridike, në cilësinë e anëtarit të komisionit të hartimit të DST dhe specifikimeve teknike;
4. **I.R.,** me detyrë inspektore finance, në cilësinë e anëtarit të njësisë së prokurimit dhe hartimit të DST;
5. **A.A**., me detyrë inspektore urbanistikës, në cilësinë e anëtarit të njësisë së prokurimit dhe hartimit të DST;
6.**E.H.,** me detyrë specialist i kadastrës, në cilësinë e anëtarit të komisionit të hartimit të specifikimeve teknike;
7. **E.B**., me detyrë përgjegjës i urbanistikës, në cilësinë e anëtarit të komisionit të hartimit të DST dhe specifikimeve teknike;

8. **H.T**., me detyrë drejtor i bujqësisë në Bashkinë Belsh, në cilësinë e kryetarit të komisionit të vlerësimit të ofertave (KVO);
9.**A.N**., me detyrë drejtor ekonomik në cilësinë e anëtarit të KVO;
10. **E.B**., me detyrë përgjegjës i urbanistikës, në cilësinë e anëtarit të KVO;
11.**E.M**., me detyrë shefe kabineti, në cilësinë e anëtarit të KVO.

## E. PËR PUNONJËSIT E LARGUAR

Për ish punonjësit e mëposhtëm nuk rekomandojmë masa disiplinore edhe pse shkeljet e natyrës administrative të konstatuara, pavarësisht se ekzistojnë nuk mund të ezaurohen si të tilla, pasi personat e sipërpërmendur nuk janë në marrëdhënie pune me këtë institucion dhe nuk ka adresim institucional për dhënien e zbatimin e tyre.
1. **F.B.**me detyrë ish juriste, në cilësinë e anëtares së njësisë së prokurimit, ndërprerë marrëdhëniet e punës në datën 10.04.2017.
2. **E.N.**me detyrë ish përgjegjës i zyrës juridike, në cilësinë e anëtarit të njësisë së prokurimit, ndërprerë marrëdhëniet e punës në datën 15.05.2017.
3. **E. P**., me detyrë ish përgjegjës i taksave dhe tarifave vendore, cilësinë e anëtarit të njësisë së prokurimit, ndërprerë marrëdhëniet e punës në datën 01.03.2017.
4. **I.H**., me detyrë ish juriste, ndërprerë marrëdhëniet e punës me Bashkinë Belsh në datën 15.12.2017, në cilësinë e anëtarit të KVO.
5. **H.Xh**., me detyrë ish përgjegjës i urbanistikës, ndërprerë marrëdhëniet e punës me Bashkinë Belsh në datën 01.11.2016, në cilësinë e anëtarit të KVO.

## F. NJOFTIMI I DEPARTAMENTIT TË ADMINISTRATËS PUBLIKE DHE KOMISIONERIT TË MBIKËQYRJES SË SHËRBIMIT CIVIL

Për punonjësit për të cilët janë rekomanduar masa disiplinore sa më sipër, Bashkia Belsh, Njësia e Burimeve Njerëzore, pasi të zbatojë procedurat e nevojshme ligjore dhe nënligjore për fillimin e ecurisë disiplinore dhe pas përfundimeve të afateve ankimore, **të ndërmarrë veprimet si më poshtë**:
**a.** Të njoftojë Departamentin e Administratës Publike, për regjistrimin e masës disiplinore në Regjistrin Qendror të Personelit, në zbatim të neneve 7 dhe 17, të ligjit nr. 152/2013 ”Për Nëpunësin Civil”, i ndryshuar.
**b**. Të njoftojë Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në zbatim të nenit 11, të ligjit nr. 152/2013 ”Për Nëpunësin Civil”, i ndryshuar.

## G.1. KALLËZIM PENAL

Bazuar në nenin 281 të ligjit nr. 7905, datë 21.03.1995 “Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, sugjerojmë trajtimin e detajuar tekniko-juridik nga ana e Departamentit Juridik dhe Kontrollit të Zbatimit të Standarteve, të materialeve të evidentuara nga grupi i auditimit në kuptim të referencave të Kodit Penal, *për z. **A.T.**, me detyrë kryetar i Bashkisë Belsh, në cilësinë e titullarit të Autoritetit Kontraktor, për shkeljet e mëposhtme:*
-Në tenderin me objekt “*Shtese kontrate për Projektin Rilindja Belsh (Belsh Qendër-Kryqëzimi Qafeshkallë)*”, me fond limit 29,166,660 lekë, zhvilluar në datën 07.02.2017, nga Titullari z.**A.T**.

nëpërmjet urdhrit të prokurimit nr.177/6 datë 03.02.2017, është përcaktuar procedura e prokurimit "Me negocim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës", shtesë kontrate, procedurë në kundërshtim me kuadrin rregullator në fuqi për prokurimin publik.
Me shtesën e kontratës nga Autoriteti Kontraktor Bashkia Belsh është ndërtuar segmenti i rrugës: "*Belsh Qendër-Kryqëzimi Qafëshkallë"*, i cili nuk ka lidhje me kontratën fillestare bazë me objekt "*Projekti i Asamblit Rilindja, Belsh",* zhvilluar në datën 02.06.2016", vlerë 149,964,467 lekë, së cilës i është referuar Autoriteti Kontraktor për të justifikuar shtesën e kontratës. Nuk ka ekzistuar asnjë rrethanë ligjore që të justifikojë kryerjen e punimeve në këtë objekt prokurimi nëpërmjet shtesës së kontratës me procedurën "Me negocim pa shpallje paraprake". Për kryerjen e punimeve, duhej të ishte zhvilluar procedura e prokurimit "Tender i hapur". Në këtë mënyrë Titullari i AK nuk ka nxitur pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në tender, nuk ka nxitur konkurrencën ndërmjet tyre, ka devijuar procedurën e prokurimit, nuk ka siguruar transparencë në zhvillimin e procedurës së prokurimit dhe përzgjedhjen e fituesit, pasi tenderi nuk është hedhur në sistemin e APP dhe fituesi nuk ka dalë si rrjedhojë e konkurimit, fondet publike janë përdorur në mënyrë jo të ligjshme, pa eficencë dhe efikasitet.
Për realizimin e punimeve, në datën 10.02.2017 është bërë lidhja e kontratës me numër protokolli 177/10, midis Autoritetit Kontraktor (AK) Bashkia Belsh, përfaqsuar nga Kryetari i Bashkisë z. **A.T.**, në cilësinë e Titullarit të Autoritetit Kontraktor dhe Kontraktorit **"V.H." SHPK**, përfaqsuar nga administratori z. **K.H.**.
Për sa më lartë ngarkohet me përgjegjësi Titullari i AK z. **A.T.**, si personi i vetëm në përcaktimin e procedurës së prokurimit dhe nënshkrimin e kontratës me kontraktorin
Në veprimet e mosveprimet e mësipërme nga Titullari i Autoritetit Kontraktor, z. **A.T**. *është vepruar në kundërshtim me:*
- Ligjin 9643 "Për prokurimi publik", datë 20.11.2006, i ndryshuar, nenin 1 "Objekti dhe qëllimi", pika 1, 2/a/b/c/ç/dh, nenin 2, "Parimet e përzgjedhjes", nenin 33 "Procedura me negocim, pa shpallje paraprake të njoftimit";
- VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", nenin 36 "Procedura me negocim, pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës", nenin 56 "Titullari i autoritetit kontraktor ose zyrtari i autorizuar" ***(Trajtuar më hollësisht nga faqja 90 deri në faqen 93 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).***

## G.2. KALLËZIM PENAL

Bazuar në nenin 281 të ligjit nr. 7905, datë 21.03.1995 "Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, sugjerojmë trajtimin e detajuar tekniko-juridik nga ana e Departamentit Juridik dhe Kontrollit të Zbatimit të Standardeve, të materialeve të evidentuara nga grupi i auditimit në kuptim të referencave të Kodit Penal, edhe **për 3 personat si më poshtë:**
**1. H.T.**, me detyrë drejtor i bujqësisë në Bashkinë Belsh, në cilësinë e kryetarit të komisionit të vlerësimit të ofertave (KVO), për shkeljet e konstatuara gjithsej në 4 tendera. Shkeljet e konstatuara në 1 prej tyre ka shkaktuar **dëm ekonomik për buxhetin e njësisë vendore në vlerën 10,454,871 lekë** (*Në tenderin me objekt "Sistemim asfaltim rruga Belsh-Qafshkallë", me fond limit 57,999,000 lekë pa TVSH zhvilluar në datën 15.09.2016)*; Shkeljet e konstatuara në në 3 tendera të tjerë, kanë shkaktuar kualifikim dhe si rezultat shpallje fitues të operatorve ekonomik, në kundërshtim me kërkesat ligjore, pasi nuk plotësojnë kriteret e vendosura në DST, me pasoj **përdorim të fondeve publike pa ekonomicitet, efiçencë dhe efektivitet**, **në vlerën totale 156,166,466 lekë** (*Në tenderin me objekt "Projekti i Asamblit Rilindja, Belsh", me fond limit 150,668,075 lekë pa TVSH zhvilluar në datën 02.06.2016", tenderin "Blerje karburanti*

*gazoil për vitin 2016", zhvilluar në datën 29.02.2016 me fond limit 4,200,000 lekë"; tenderin "Kontenier pastrimi", me fond limit 2,153,060 lekë pa TVSH zhvilluar në datën 14.07.2016). Trajtuar më hollësisht nga faqja 51-53 dhe 62-80 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

**2. H.Xh.**, me detyrë ish përgjegjës i urbanistikës, ndërprerë marrëdhëniet e punës me Bashkinë Belsh në datën 01.11.2016, në cilësinë e anëtarit të KVO, për shkeljet e konstatuara gjithsej në 2 tendera. Shkeljet e konstatuara në 1 prej tyre, ka shkaktuar **dëm ekonomik për buxhetin e njësisë vendore në vlerën 10,454,871 lekë** (*Në tenderin me objekt "Sistemim asfaltim rruga Belsh-Qafshkallë", me fond limit 57,999,000 lekë pa TVSH zhvilluar në datën 15.09.2016);* Shkeljet e konstatuara në në 1 tender tjetër, kanë shkaktuar kualifikim dhe si rezultat shpallje fitues të operatorve ekonomik, në kundërshtim me kërkesat ligjore, pasi nuk plotësojnë kriteret e vendosura në DST, me pasojë **përdorim të fondeve publike pa ekonomicitet, efiçencë dhe efektivitet**, **në vlerën 149,964,467** lekë (*Në tenderin me objekt "Projekti i Asamblit Rilindja, Belsh", me fond limit 150,668,075 lekë pa TVSH zhvilluar në datën 02.06.2016). Trajtuar më hollësisht nga faqja 62-72 dhe 74-80 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

**3. I.H.**, me detyrë ish juriste, ndërprerë marrëdhëniet e punës me Bashkinë Belsh në datën 15.12.2017, në cilësinë e anëtarit të KVO, për shkeljet e konstatuara gjithsej në 9 tendera. Shkeljet e konstatuara në 3 prej tyre kanë shkaktuar **dëm ekonomik për buxhetin e njësisë vendore në vlerën 11,403,571 lekë** (*Në tenderin me objekt "Sistemim asfaltim rruga Belsh-Qafshkallë", me fond limit 57,999,000 lekë pa TVSH zhvilluar në datën 15.09.2016; tenderin me objekt "Skema Ujitjes e Fushes Cestie (Degëzimi Kosovë) Pjesshëm", me fond limit 11,378,173 lekë pa TVSH zhvilluar në datën 28.03.2017; tenderin me objekt "Blerje Automjet transport inertesh dhe transporin e eskavatorit me zinxhira", me fond limit 4,100,000 lekë pa TVSH zhvilluar në datën 05.09.2017).* Shkeljet e konstatuara në në 6 tendera të tjerë, kanë shkaktuar kualifikim dhe si rezultat shpallje fitues të operatorve ekonomik, në kundërshtim me kërkesat ligjore, pasi nuk plotësojnë kriteret e vendosura në DST, me pasojë **përdorim të fondeve publike pa ekonomicitet, efiçencë dhe efektivitet**, **në vlerën totale 282,088,459 lekë** (*Në tenderin me objekt "Projekti Asambli Rilindja, Belsh", me fond limit 150,668,075 lekë pa TVSH zhvilluar në datën 02.06.2016; në tenderin me objekt "Ndërtim sistemim,asfaltim rruga e Trojas", me fond limit 61,016,181 lekë zhvilluar në datën 06.03.2017; tenderin me objekt "Ndërtim i pedonales dhe korsisë së biçikletave Liqeni Belsh", me fond limit 46,098,031 lekë pa TVSH zhvilluar në datën 27.06.2017; tenderin me objekt "Rikualifikimi urban i fasadave të Qendrës Belsh", me fond limit 14,301,064 lekë pa TVSH zhvilluar në datën 07.08.2017; tenderin me objekt "Blerje karburanti për vitin 2017", me fond limit 10,000,000 lekë zhvilluar në vitin 2017; tenderin me objekt "Rikonstruksion i Godinës Bashkise Belsh", me fond limit 1,401,255 lekë zhvilluar në datën 15.08.2016). Trajtuar më hollësisht nga faqja 50-117 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

Dëmi ekonomik i shkaktuar njësisë vendore gjatë zhvillimit të procedurave të mësipërme të prokurimit publik, ka ardhur si rezultat i diferencës midis vlerës së ofertës të operatorit ekonomik të kualifikuar padrejtësisht (me vlerë më të lartë) dhe vlerës së ofertës të operatorit ekonomik të skualifikuar padrejtësisht (me vlerë më të ulët), duke sjellë shpenzimin e më shumë fondeve buxhetore. Përdorimi i fondeve publike pa ekonomicitet, efiçencë dhe efektivitet, ka ardhur si rezultat i kualifikimeve dhe shpalljen fitues të operatorve ekonomik të cilët nuk plotësojnë kriteret e vendosura në DST, e për rrjedhojë për këto mangësi nuk garantojnë kryerjen me cilësi e sukses të kontratës.

Në veprimet dhe mosveprimet e mësipërme, nga komisioni i vlerësimit të ofertave (KVO) është vepruar në kundërshtim me përcaktimet ligjore të ligjit 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, konkretisht në kundërshtim me: nenin 1, "Objekti dhe qëllimi", pika 2, shkronja b, d, dh; nenin 2 "Parimet e përzgjedhjes", pika a, c; nenin 46 "Kualifikimi i ofertuesve", pika 1; nenin 53 "Shqyrtimi i ofertave", pika 3; 5.

## G.3. KALLËZIM PENAL

Bazuar në gjetjet dhe aktet e administruara në dosjen e auditimit, në referim të Ligjit nr. 7905 datë 21.03.1995 *"Kodi i Procedurës Penale"* i ndryshuar, neni 281 të ndryshuar, Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "*Për prokurimin publik*", i ndryshuar, Ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 *"Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit"* i ndryshuar, Ligjit nr. 107/2014 *"Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit"*, i ndryshuar, Udhëzimit të Këshillit Ministrave nr. 3, datë 15.02.2001 *"Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit"* i ndryshuar, Udhëzimit të Këshillit Ministrave nr. 2, datë 13.05.2005 *"Për zbatimin e punimeve të ndërtimit"*, i ndryshuar **sugjerojmë që të vlerësohet** nga ana e Drejtorisë Juridike, Sigurimit Analizës së Riskut, të materialeve të evidentuara nga grupi i auditimit në kuptim të referencave të Kodit Penal, **për;**
**1 – A.T.** nën cilësinë e Titullarit të Autoritetit Kontraktor;
**2 – R.T.** nën cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve në 4 raste;
**3 – M.K.** nën cilësinë e kolaudatores së punimeve në 2 raste;
**4 – P.M.** nën cilësinë e kolaudatores së punimeve në 2 raste;
**5 – K.H. në 3 raste** nën cilësinë e përfaqësuesit ligjor të subjektit sipërmarrës të punimeve ***"V.H."* SHPK** me nr. licence në zbatim NZ. 3930/14 datë 31.03.2016;
**6 – E.M. në 1 rast** nën cilësinë e përfaqësuesit ligjor të subjektit sipërmarrës të punimeve ***"S.N.P."* SHPK** me nr. licence në zbatim NZ. 7095 datë 03.11.2014
Sa më sipër, sugjerohet pas konstatimeve lidhur me dëmin ekonomik të konstatuar në **4 investime publike në vlerën 42,218,657 lekë pa tvsh**, likuidimin për punime të pakryera në fakt në momentin e likuidimit duke favorizuar padrejtësisht firmën sipërmarrëse për pagesa nëpërmjet situacioneve fiktive në vlerën të paktën **29,313,840 lekë pa tvsh,** si rrjedhojë e mos realizimit të punimeve nga operatori ekonomik, sipas specifikimeve të projektit, preventivit dhe termave të referencës të dokumenteve standarde të tenderit. Këto problematika u konstatuan gjatë auditimit të dokumentacionit të vënë në dispozicion për objektet:

1. *Projekti Ansambli Rilindja*
2. *Ndërtim. Sistemim Asfaltim Rruga Trojas (Unaza Belsh)*
3. *Ndërtim i Pedonales dhe Korsise se Biçikletave Liqeni Belsh*
4. *Sistemim Asfaltim Rruga Belsh - Qafë Shkallë*

Në mënyrë më të detajuar personat dhe objektet rast pas rasti paraqiten si më poshtë:
**1. Z. R.T.**, përfaqësues ligjor i subjektit ***"Z."* SHPK**, në cilësinë e **mbikëqyrësit të punimeve**, pasi nga mos kontrolli i punimeve ka rezultuar dëm ekonomik në vlerën **42,218,657 lekë pa tvsh** respektivisht,
**a. Objekti *"Projekti Ansambli Rilindja"***, me vlerë kontrate 214,933,352 lekë me TVSH (kontrata bazë nr. – prot., datë 19.07.2016 me vlerë 179,957,360 leke me TVSH + kontrata shtesë nr. – prot., datë 10.02.2017 me vlerë 34,975,992 lekë me TVSH), nuk janë kryer 19 zëra punimesh si dhe është përfshirë tvsh – ja pajisjeve për 3 zëra, duke i shkaktuar buxhetit të Bashkisë një dëm ekonomik në vlerën **18,439,582 lekë.**
**b. Objekti *"Ndërtim i Pedonales dhe Korsisë së Biçikletave Liqeni Belsh"***, kontrata nr. – prot., datë 18.07.2017 me vlerë 55,103,905 lekë me TVSH, nuk janë kryer 9 zëra punimesh duke i shkaktuar buxhetit të Bashkisë një dëm ekonomik në vlerën **3,006,705 lekë.**

**c. Objekti *"Sistemim Asfaltim Rruga Belsh - Qafë Shkallë"***, kontrata nr. – prot., datë 11.10.2016 me vlerë kontrate 60,483,858 lekë me TVSH, nuk janë kryer 3 zëra punimesh si dhe nuk është përshtatur zëri në situacion sipas zërit të kryer në fakt për 1 zë, duke i shkaktuar buxhetit të Bashkisë një dëm ekonomik në vlerën **11,466,250** lekë pa TVSH. Për këtë objekt janë lidhur kontratat përkatëse sipas akteve me nr. prot., datë 19.07.2016 dhe amendament nr. – prot.,

datë 10.02.2017, nr. – prot., datë 18.07.2017 dhe nr. – prot., datë 11.10.2016 mes Titullarit të AK Bashkia Belsh dhe përfaqësuesit ligjor të subjektit ***"V.H."*** **SHPK**, me nr. licence NZ. 3930/14 datë 31.03.2016 **K.H.**

-Në objektin *"Sistemim Asfaltim Rruga Belsh - Qafë Shkallë"* u konstatua se janë kryer likuidime për punime të pakryera në fakt në momentin e likuidimit duke favorizuar padrejtësisht firmën sipërmarrëse për pagesa nëpërmjet situacioneve fiktive në vlerën të paktën **29,313,840 lekë pa TVSH** (Trajtuar më hollësisht në faqen x deri y të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

**d. Objekti *"Ndërtim. Sistemim Asfaltim Rruga Trojas (Unaza Belsh)"*** sipas kontratës nr. – prot., datë 18.04.2017 me vlerë 73,156,814 lekë me TVSH, nuk janë kryer 7 zëra punimesh duke i shkaktuar buxhetit të Bashkisë një dëm ekonomik në vlerën **9,306,120 lekë pa TVSH**

Për kolaudimin e punimeve të përfunduara për objektin e parë, nga auditimi nuk rezultoi kontratë shërbimi ndërsa për objektin e dytë është lidhur kontrata përkatëse mes Titullarit të AK Bashkia Belsh dhe ing. **M.K**. sipas aktit me nr. - prot., datë 25.10.2017.

Për mbikëqyrjen e kontratave të mësipërme të sipërmarrjes janë lidhur kontratat përkatëse të shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve mes Titullarit të AK Bashkia Belsh dhe përfaqësuesit ligjor të subjektit **"Z."** , ing. **R.T**. sipas akteve me nr. 2323 prot., datë 19.09.2016, nr. – prot., datë 12.05.2017, nr. - prot., datë 01.08.2017 dhe nr. – prot., datë 23.11.2016.

Nga ana e mbikëqyrësit të punimeve ***ing. R.T.*** nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore dhe kontraktuale të bëra në:

**1)** Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 *"Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi"*, i ndryshuar, Kreu III, neni 7, <u>*ku përcaktohet se:*</u> *"Mbikëqyrësi i punimeve është i detyruar të kontrollojë periodikisht dhe në fazat më kryesore, librin e kantierit dhe është përgjegjës për saktësinë vërtetësinë e dokumenteve dhe cilësinë e punimeve të ndërtimit."*

**2)** Kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve sipas aktit me nr. - prot., datë 23.11.2016

**3)** Udhëzimi i KM nr. 3 datë 15.02.2001 *"Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit"*, i ndryshuar me Udhëzimin Nr. 1, datë 16.6.2011, Kreu I, pika 3, nënpikat 3.2 dhe 3.3 <u>*ku përcaktohet se*</u>: *3.2 Libreza e masave për punimet e ndërtimit është dokumentacioni bazë për verifikimin e saktësisë së vëllimeve të punimeve të ndërtimit, të vendosura në situacion. Kjo librezë hartohet nga drejtuesi teknik i objektit dhe firmoset nga ai, nga mbikëqyrësi i punimeve dhe nga përfaqësuesi ligjor i sipërmarrësit, për të cilin është miratuar leja e ndërtimit.*

**2. M.K.,** në cilësinë e kolaudatores së punimeve, pasi nga mos kontrolli i punimeve të përfunduara ka rezultuar një dëm ekonomik në vlerën **20,524,292 lekë pa tvsh**, respektivisht:

**a. Objekti *"Projekti Ansambli Rilindja"***, me vlerë të kontratës 179,957,360 leke me TVSH të lidhur sipas aktit me nr. – prot., datë 19.07.2016 (kontrata bazë), nuk janë kryer 9 zëra punimesh si dhe është përfshirë tvsh – ja pajisjeve për 3 zëra, duke i shkaktuar buxhetit të Bashkisë një dëm ekonomik në vlerën **11,218,172 lekë.**

**b. Objekti *"Ndërtim. Sistemim Asfaltim Rruga Trojas (Unaza Belsh)"*** sipas kontratës nr. – prot., datë 18.04.2016 me vlerë 73,156,814 lekë me TVSH, nuk janë kryer 7 zëra punimesh duke i shkaktuar buxhetit të Bashkisë një dëm ekonomik në vlerën **9,306,120 lekë pa TVSH**

Për kolaudimin e punimeve të përfunduara për objektin e parë, nga auditimi nuk rezultoi kontratë shërbimi ndërsa për objektin e dytë është lidhur kontrata përkatëse mes Titullarit të AK Bashkia Belsh dhe ing. **M.K**. sipas aktit me nr. - prot., datë 25.10.2017.

** Për objektin "Projekti Ansambli Rilindja", ing.* ***M.K.****ka qenë kolaudatore e punimeve për kontratën bazë.*

**3. P.M.,** në cilësinë e kolaudatores së punimeve, pasi nga mos kontrolli i punimeve të përfunduara ka rezultuar një dëm ekonomik në vlerën 42,218,657 lekë pa tvsh respektivisht;

**a. Objekti** ***"Projekti Ansambli Rilindja****"*, me vlerë të kontratës 34,975,992 leke me TVSH të lidhur sipas aktit me nr. – prot., datë 10.02.2017 (kontrata shtesë), nuk janë kryer 10 zëra punimesh, duke i shkaktuar buxhetit të Bashkisë një dëm ekonomik në vlerën **7,221,410 lekë.**
(Trajtuar më hollësisht në faqen x deri y të Raportit Përfundimtar të Auditimit)
**b. Objekti** ***"Sistemim Asfaltim Rruga Belsh - Qafë Shkallë",*** kontrata nr. – prot., datë 11.10.2016 me vlerë kontrate 60,483,858 lekë me TVSH, nuk janë kryer 3 zëra punimesh si dhe nuk është përshtatur zëri në situacion sipas zërit të kryer në fakt për 1 zë, duke i shkaktuar buxhetit të Bashkisë një dëm ekonomik në vlerën 11,466,250 lekë pa TVSH. Për këtë objekt janë lidhur kontratat përkatëse sipas akteve me nr. prot., datë 19.07.2016 dhe amendament nr. – prot., datë 10.02.2017, nr. – prot., datë 18.07.2017 dhe nr. – prot., datë 11.10.2016 mes Titullarit të AK Bashkia Belsh dhe përfaqësuesit ligjor të subjektit **"V.H." SHPK**, me nr. licence NZ. 3930/14 datë 31.03.2016 **K.H**.
Për kolaudimin e punimeve të përfunduara për objektin e parë, është lidhur kontrata e shërbimit të kolaudimit mes AK Bashkia Belsh dhe ing. **P.M**. sipas aktit me nr. 11.05.2017 ndërsa për objektin e dytë është lidhur kontrata përkatëse mes Titullarit të AK Bashkia Belsh dhe ing. **P.M**. aktit me nr. - prot., datë 01.03.2017.
** Për objektin "Projekti Ansambli Rilindja", ing.* ***P.M****. ka qenë kolaudatore e punimeve për kontratën shtesë.*
Nga ana e kolaudatoreve të punimeve ***ing. M.K.***dhe ***ing. P.M.***nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore dhe kontraktuare të bëra në:
1) Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 *"Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi"*, i ndryshuar, Kreu III, neni 12, ku përcaktohet se: *"Të gjitha objektet e përkufizuara në nenin 3 duhet t'i nënshtrohen kolaudimit tekniko ekonomik, i cili ka për qëllim të verifikojë nëse: 1. objekti është realizuar në kushtet teknike; 2. objekti është realizuar në përputhje me kontratën dhe anekset e saj; 3. çmimet e aplikuara janë sipas përcaktimeve të kontratës; 4. në këtë akt verifikohen edhe kërkesat e zbatuesit të paraqitura gjatë zbatimit të punimeve"*
2) Udhëzimin e KM nr. 3 datë 15.02.2001 *"Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit"* e konkretisht Kreu II, Pika 3 ku përcaktohet se*:*
*Kolaudatori ose grupi i kolaudimit duhet të verifikojë me përgjegjësi:*
*a. Realizimin e objektit, në përputhje me projektin, lejen e ndërtimit, standardet dhe rregullat teknike.*
*b. Realizimin e objektit, në përputhje me kontratën e nënshkruar.*
*c. Përputhjen e dokumenteve me të dhënat nga matjet në dimension, formë, sasi dhe cilësi.*
*ç. Përputhjen e vlerës së preventivuar dhe të kontraktuar me atë të paraqitur në situacionin përfundimtar, si dhe sqarimet përkatëse, në rastet e mospërputhjes.*

**4. K.H.** nën cilësinë e përfaqësuesit ligjor të subjektit ***"V.H."*** **SHPK**;

**5. E.M.** nën cilësinë e përfaqësuesit ligjor të subjektit ***"S.N.P."*** **SHPK**:

1) Nuk është zbatuar Ligji nr. 8402, datë 10.09.1998 *"Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi"*, i ndryshuar, Kreu III, neni 8 ku përcaktohet se: *"...Zbatuesi i punimeve mban përgjegjësi dhe* ***është i detyruar të realizojë punimet e ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin****, kushtet teknike të zbatimit dhe rregullat e sigurimit teknik. Ai duhet të sigurojë cilësinë e materialeve të ndërtimit dhe produkteve të ndërtimit, të cilat duhet të plotësojnë kërkesat e projektit në përputhje me standardet kombëtare ose evropiane. Me materiale dhe produkte ndërtimi kuptohet çdo produkt i prodhuar për t'u përfshirë në mënyrë të përhershme në punimet e ndërtimit."*;
2) Nuk janë zbatuar kontratat e sipërmarrjes së punimeve të lidhura me AK Bashkia Belsh sipas akteve me nr. prot., datë 19.07.2016 dhe amendament nr. – prot., datë 10.02.2017, nr. – prot.,

datë 18.07.2017 dhe nr. – prot., datë 11.10.2016 (***"V.H."* SHPK**) dhe nr. – prot. datë 18.04.2016 (***"S.N.P."* SHPK**);
3) Nuk janë marrë masa për zbatimin e Udhëzimit nr. 2 datë 13.05.2005 *"Për zbatimin e punimeve të ndërtimit"*, Kreu I, pika 7, Kreu II, pika 8.1 ku përcaktohet se: *"Zërat, sasitë, çmimet jashtë kontratës dhe përdorimi i fondit rezervë në situacionin përfundimtar justifikohen me dokumentacionin përkatës"* si dhe pika 8.3 e po këtij udhëzimi ku përcaktohet se: *"Çmimet jashtë kontratës caktohen sipas analizave teknike në fuqi, me vlerën ekonomike më të mirë"*.

## G.4. KALLËZIM PENAL

Bazuar në gjetjet dhe aktet e administruara në dosjen e auditimit, në referim të Ligjit nr. 7905 datë 21.03.1995 *"Kodi i Procedurës Penale"* i ndryshuar, neni 281 të ndryshuar, Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "*Për prokurimin publik*", i ndryshuar, Ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 *"Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit"* i ndryshuar, Ligjit nr. 107/2014 *"Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit"*, i ndryshuar, Udhëzimit të Këshillit Ministrave nr. 3, datë 15.02.2001 *"Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit"* i ndryshuar, Udhëzimit të Këshillit Ministrave nr. 2, datë 13.05.2005 *"Për zbatimin e punimeve të ndërtimit"*, i ndryshuar **sugjerojmë që të vlerësohet** nga ana e Drejtorisë Juridike, Sigurimit Analizës së Riskut, të materialeve të evidentuara nga grupi i auditimit në kuptim të referencave të Kodit Penal, **për;**
**1–K.H.** nën cilësinë e përfaqësuesit ligjor të subjektit sipërmarrës të punimeve ***"V.H."* SHPK** me nr. licence në zbatim NZ. 3930/14 datë 31.03.2016;
**2 – R.T.** nën cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve;
**3 – M.K.** nën cilësinë e kolaudatores së punimeve të kontratës bazë;
- Në objektin *"Projekti Ansambli Rilindja, Belsh"*, ku nga auditimi i projektit, specifikimeve teknike, dokumentacionit teknik të zbatimit, mbikëqyrjes dhe kolaudimit të punimeve të ndërtimit të administruara në dosjen teknike rezultoi se sheshi kryesor dhe pranë godinave, sipas projektit ishte parashikuar të shtrohej me gurë troktolit, ndërsa pllakat e gurit të shtruara në sheshin kryesor dhe pranë godinave, nuk janë pllaka prej guri troktolit (formacion shkëmbor magmatike), por një pjesë janë pllaka guri të marrë nga formacione shkëmbore ranore të imta (kategoria sedimentarë) dhe një pjesë janë pllaka guri të marrë nga formacione shkëmbore gëlqerore (kategoria sedimentarë).
Vlera totale e paguar në situacionin përfundimar për zërin "Shtrim me pllaka guri troktolit" është ***51,820,470 lekë pa TVSH,*** vlerë e cila është shpenzuar nga autoriteti kontraktor për një zë punimesh, i cili nuk është realizuar nga operatori ekonomik, sipas specifikimeve të projektit, preventivit dhe termave të referencës të dokumenteve standarde të tenderit. Në dosje nuk administrohen çertifikatat e cilësisë së materialeve të përdorur, përfshirë edhe certifikatën e gurit troktolit.
Gjithashtu është audituar dhe objekti për realizimin e dy pedonaleve "Ndërtimi i pedonaleve dhe korsive të biçikletave, Liqeni Belsh" Nr.pa protokoll datë 18.07.2017, vazhdimësi e sheshit kryesor dhe korsive të bicikletave, të cilat janë pjesa integrale e "Projektit të Ansamblit Rilindja", të realizuara nga po i njëjti sipërmarrës "V.H." SHPK, ku u konstatua se në pjesën e majtë është realizuar me *"Trotuar me pllaka me përbërje guri gëlqeror"*, **identike** me pllakat e përdorura për një pjesë të sheshit kryesor dhe pranë godinave të "Ansamblit Rilindja", por të realizuara me çmimin 3,500 lekë/m$^2$. Diferenca e çmimit njësi është 6500 lekë/m$^2$ -3500 lekë/m2 =3,000 lekë/m$^2$. Për volumin e punës 7972.38 m$^2$, diferenca në vlerë është 23,917,140 lekë pa TVSH. Në qoftëse do të ishte aplikuar i njëjti çmim edhe për pllakat e vendosura (të cilat nuk janë pllaka troktolite) në objektin "Projekti Ansambli Rilindja", për këtë zë punimesh, ***autoriteti kontraktor do të kishte shpenzuar më pak 23,917,140 lekë pa T.V.SH , vlerë e cila përbën dëm ekonomik për Buxhetin e Shtetit dhe Njësisë Vendore.***

-Nga ana e mbikëqyrësit të punimeve ***ing. R.T.*** nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore dhe kontraktuale të bëra në:

**1)** Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 *"Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi"*, i ndryshuar, Kreu III, neni 7, ku përcaktohet se: *"Mbikëqyrësi i punimeve është i detyruar të kontrollojë periodikisht dhe në fazat më kryesore, librin e kantierit dhe është përgjegjës për saktësinë vërtetësinë e dokumenteve dhe cilësinë e punimeve të ndërtimit."*

**2)** Kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve sipas aktit me nr. - prot., datë 23.11.2016

**3)** Udhëzimi i KM nr. 3 datë 15.02.2001 *"Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit"*, i ndryshuar me Udhëzimin Nr. 1, datë 16.6.2011, Kreu I, pika 3, nënpikat 3.2 dhe 3.3 ku përcaktohet se: *3.2 Libreza e masave për punimet e ndërtimit është dokumentacioni bazë për verifikimin e saktësisë së vëllimeve të punimeve të ndërtimit, të vendosura në situacion. Kjo librezë hartohet nga drejtuesi teknik i objektit dhe firmoset nga ai, nga mbikëqyrësi i punimeve dhe nga përfaqësuesi ligjor i sipërmarrësit, për të cilin është miratuar leja e ndërtimit.*

-Nga ana e kolaudatores të punimeve ***ing. M.K.*** nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore dhe kontraktuare të bëra në:

1) Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 *"Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi"*, i ndryshuar, Kreu III, neni 12, ku përcaktohet se: *"Të gjitha objektet e përkufizuara në nenin 3 duhet t'i nënshtrohen kolaudimit tekniko ekonomik, i cili ka për qëllim të verifikojë nëse: 1. objekti është realizuar në kushtet teknike; 2. objekti është realizuar në përputhje me kontratën dhe anekset e saj; 3. çmimet e aplikuara janë sipas përcaktimeve të kontratës; 4. në këtë akt verifikohen edhe kërkesat e zbatuesit të paraqitura gjatë zbatimit të punimeve"*

2) Udhëzimin e KM nr. 3 datë 15.02.2001 *"Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit"* e konkretisht Kreu II, Pika 3 ku përcaktohet se:

*Kolaudatori ose grupi i kolaudimit duhet të verifikojë me përgjegjësi:*

*a. Realizimin e objektit, në përputhje me projektin, lejen e ndërtimit, standardet dhe rregullat teknike.*

*b. Realizimin e objektit, në përputhje me kontratën e nënshkruar.*

*c. Përputhjen e dokumenteve me të dhënat nga matjet në dimension, formë, sasi dhe cilësi.*

-Nga ana e **z.K.H.** nën cilësinë e përfaqësuesit ligjor të subjektit ***"V.H."* SHPK**

1)Nuk është zbatuar Ligji nr. 8402, datë 10.09.1998 *"Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi"*, i ndryshuar, Kreu III, neni 8 ku përcaktohet se: *"...Zbatuesi i punimeve mban përgjegjësi dhe **është i detyruar të realizojë punimet e ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin**, kushtet teknike të zbatimit dhe rregullat e sigurimit teknik. Ai duhet të sigurojë cilësinë e materialeve të ndërtimit dhe produkteve të ndërtimit, të cilat duhet të plotësojnë kërkesat e projektit në përputhje me standardet kombëtare ose evropiane. Me materiale dhe produkte ndërtimi kuptohet çdo produkt i prodhuar për t'u përfshirë në mënyrë të përhershme në punimet e ndërtimit."*;

2) Nuk ka zbatuar kontratën e sipërmarrjes së punimeve "Ansambli Rilinda"t ë lidhur me AK Bashkia Belsh sipas akteve me nr. prot., datë 19.07.2016.

Tabelë shpjeguese për materialin e mësipërm

| Nr. | Objekti prokurimit | Fondi limit (pa tvsh) | Kontrata Bazë (me tvsh) | Kontratë shtesë (me tvsh) | OE fitues | Data e kontratës | Mbikëqyrësi i punimeve | Kolaudatori i Punimeve | Probleme të tjera | Dëmi ekonomik |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Projekti Ansambli Rilindja | 150,668,075 | 179,957,360 | 34,975,992 | V.H. | nr. - prot datë 19.07.2016 nr. - prot., datë 10.02.2017 | R.T. | M.K. P.M. | Mosrespektim i specifikimeve | **18,439,582 +23,917,140** |
| 2 | Ndërtim. Sistemim Asfaltim Rruga | 61,016,181 | 73,156,814.4 | - | S.N.P. & E. | nr. - prot datë 18.04.2016 | R.T. | M.K. | | **9,306,120** |

| | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Trojas (Unaza Belsh) | | | | | | | | | |
| 3 | Ndërtim i Pedonales dhe Korsise së Biçikletave Liqeni Belsh | 46,098,026 | 55,103,905 | - | V.H. | nr. - prot datë 18.07.2017 | R.T. | Pa Kolauduar | Mosrespektim i specifikimeve | **3,006,705** |
| 4 | Sistemim Asfaltim Rruga Belsh - Qafë Shkallë | 50,403,215 | 60,483,858 | - | V.H. | nr. - prot datë 11.10.2016 | R.T. | P.M. | Likuidim paradhënie vlera **29,313,840** | **11,466,250** |
| | | | | | | | | | **TOTAL** | **66,135,797** |

*Shënim:[1] Në rastin e fillimit të proceseve gjyqësore në funksion të zbatimit të këtij rekomandimi,nga ana e Bashkisë, të kërkohet prezenca e KLSH-së, si palë e tretë në proces gjyqësor, duke e njoftuar me shkresë zyrtare KLSH-në, në lidhje me ecurinë dhe zhvillimet përgjatë procesit gjyqësor dhe në të gjitha shkallët e gjykimit.*

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore dhe Departamenti Juridik, Zbatimit të Standardeve dhe Etikës.

---

**BUJAR LESKAJ**

**K R Y E T A R**